

ERJON PAPAGJONI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë
epapagjoni@gmail.com

**VITI 1967 – HISTORIA E GODITJES SË ORGANIZUAR MBI
FENË DHE INSTITUCIONET E SAJ****Abstrakt:**

Goditja që iu bë klerit dhe fesë nga PPSH-ja në vitin 1967 shkaktoi një traumë sociale e kombëtare të pashembullt. Përpjekja për t'i defaktorizuar ata nga impakti shpirtëror, moral e social që kishin, duke i paraqitur si pjesë të zvetënuara, irracionale dhe reaksionare të shoqërisë ishte pjesë e një politike konsekuente për dobësimin e faktorit fetar, e cila kulmoi me atë që u quajt "revolucionarizimi i mëtejshëm i jetës së vendit". PPSH-ja e adresoi sulmin e saj në shkatërrimin e të gjitha institucioneve, tempujve dhe infrastrukturës së klerit.

Lidershipi i saj nxiti e keqpërdori turmat e indoktrinuara ideologjikisht, kryesisht rininë shkollore, duke i dhënë lëvizjes në dukje formën e një shpërthimi spontan, por në të vërtetë e mirorganizuar. E paraqitur si lëvizje mbarëpopullore, e ngjashme për nga modeli me tubimet e gardistëve të kuq gjatë Revolucionit Kulturor në Kinë, ajo u orkestrua e gjitha nga PPSH-ja dhe drejtuesi i saj Enver Hoxha. Kjo lëvizje ishte në thelb politike. Ajo përfaqësonte, më së pari, goditjen e lirisë së ndërgjegjes si liri dhe e drejtë njerëzore, kushtetuese, e cila është mirëfilli e natyrës morale e shpirtërore.

Ndalimi i ritualeve e kremtimeve fetare, i zakoneve që ishin rrënjëzuar nëpër shekuj, denoncimi i fesë dhe i klerikëve të saj si gjoja "reaksionarë", poshtërimi i tyre, rrënimi i institucioneve të kultit, asgjësimi i inventarit të tyre, përveçse nxori në syprinë keqpërdorimin e njerëzve nga ana e pushtetit dhe kthimin e tyre në turma destruktive, mundësoi krijimin e kushteve edhe për institucionalizimin nga pikëpamja kushtetuese të ateizmit në vitin 1976, duke e shpallur Shqipërinë vendin e vetëm ateist në botë.

Fjalë kyçe:

Shtet, fe, komunizëm, rini, revolucion, liri.

Hyrje

Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik, e kthyer nga Lindja e Largët dhe eksperiencia e “komunizmit kinez” prej nga ekonomia shqiptare përfitonte injeksionet financiare dhe ekonomike për t’i shpëtuar kolapsit, PPSH-ja u bë një imituese e nismave politike radikale që inicioi Partia Komuniste e Kinës dhe Mao Ce Duni, posaçërisht me Revolucionin Kulturor. Ky i ashtuquajtur revolucion kulturor u bë referenca e lakuar politike për Partinë e Punës së Shqipërisë dhe liderin e saj Enver Hoxha, e shprehur edhe në fjalën e tij të 6 shkurtit 1967: “Kundër zakoneve prapanike dhe paragjykimëve fetare”. Me një popullsi tashmë të dyfishuar në raport me nëntorin e 1944-s (pra, një masë prej një milion njerëzish të lindur dhe të rritur pas ardhjes në pushtet të komunistëve, të cilët ishin thellësisht të indoktrinuar), udhëheqësi shqiptar ndihej edhe më i sigurt në lëvizjet e tij. Ai kishte bindjen se jeta mund të revolucionarizohej edhe më tej sipas modelit komunist që kishte në kokë dhe kjo masë e madhe të rinjsh militantë i jepte vetëbesimin për të kryer misionin e tij. Rinia shkollore, lehtësisht e manipulueshme, do të ishte pika më e fortë mbështetëse. Shkolla iu largua kështu edhe më shumë brendisë dhe karakterit të saj mësimdhënëse.

Në një shumicë rastesh ajo ofroi bashkëpjesëmarrje aktive në veprimtaritë e mirëfillta politike e sociale të vendit dhe jo një herë u shndërrua në aktor politik, pasi e konsideronte këtë pjesëmarrje si parakusht të edukimit komunist të nxënësve. Sipas studiueses Eriketa Kambo, e gjithë kjo lëvizje, u shoqërua si një *copy paste* me forcimin e boshtit ideologjik në shkollë, futjen e lëndëve të njohurive të marksizëm-leninizmit, ngritjen e kultit të jashtëzakonshëm të figurës së Enver Hoxhës, falë një mitizimi thuajse me natyrë religjioze si dhe krijimin e turmave sociale kompakte. Sloganet e shkëputura nga fjalimet e Hoxhës u shndërruan në paragrafë të rinj “biblikë” a “sure kuranore”, një lloj Talmudi i komunistëve shqiptarë i paraqitur si doktrinë e pagabueshme, si atribut i së drejtës juridike, si e vërteta absolute e tyre. Lëvizja kundër fesë krijoi një situatë frike. Mijëra kopje të civateve të udhëheqësit komunist shqiptar, njësoj si citatat e Mao Ce Dunit, shërbyen si Bibël e Re, ku njerëzit duhej të ballafaqoheshin, të korrigjonin gabimet, të formatoheshin nën sloganin e “njeriut të ri”. Ndikimi i Revolucionit Kulturor në Kinë ishte i madh dhe thelbësor, qoftë i pohuar në fillim si

përvojë revolucionare, kur marrëdhëniet midis PPSH-së dhe Partisë Komuniste të Kinës ishin të shkëlqyera, qoftë kur këto marrëdhënie u prishën e ky i ashtuquajtur revolucion u mohua dhe u kritikua. PPSH-ja ndoqi po ato metoda të lartësimit të kultit të individit të Enver Hoxhës si dhe stalinistët e dikurshëm me liderin e tyre despotik apo komunistët kinezë me kultin e Mao Ce Dunit, duke e kthyer atë (E. Hoxhën) në një “Perëndi të gjallë në tokë”.

Atëherë, si premisë e parë, edhe në rrafshin e filozofisë politike, duhet pohuar se:

1. Falë autoritetit politik të padiskutueshëm që iu atribuua Enver Hoxhës, siç ishte krijimi i kultit të tij, PPSH-ja e çshenjtëroi figurën e Zotit dhe çdo doktrinë fetare duke shenjtëruar, përkundrazi, një tjetër Zot e një tjetër doktrinë: liderin komunist dhe marksizëm-leninizmin. I vetmi Zot në botën e vogël shqiptare duhej të ishte pikërisht ky lider dhe PPSH-ja. Njerëzit mund të shkonin dhe të luteshin këtej e tutje, të gjenin mbështetje dhe të kryenin katarsisin e tyre për fajet dhe gabimet që kishin bërë, rrjedhimisht të fitonin fuqinë e përtëritjes, tejkalimin e fajit, ndreqjen e gabimit të kryer, pra të merrnin “bekimin” apo, në termat fetarë “ekuarestinë”, vetëm tek organet partiake dhe jo në një tempull fetar; të besonin vetëm fjalët e liderit komunist dhe jo kanonet e shenjta të Perëndisë. Perëndia në qiell zëvendësohej kështu me udhëheqësin në tokë. Kjo ngjasonte me konceptin e Ajnshtajnit, e një Zoti “antropologjik”.¹

2. PPSH-ja nuk e donte aspak një Zot të butë në qiell, që falte mëshirë dhe pajtonte njerëzit. Përkundrazi, ajo donte një Zot të rreptë në tokë, që ishte i pamëshirshëm ndaj armikut të klasës, pra dhe fesë, institucioneve fetare e klerikëve, të cilat ishin cilësuar si të tilla. Prandaj e vetëshpallte udhëheqësin e saj si një Zot të ri, që duhej t’i shfaroste këta armiq të kamufluar të klasës, t’ua hiqte çdo pushtet dhe ndaj tyre të ngjallte urrejtjen klasore, sepse ata u shërbenin klasave shfrytëzuese etj. Pra dhe fenë, e cila konceptohej si një pushtet pajtimi, mëshire dhe faljeje më pas, me Kushtetutën e vitit 1976, PPSH-ja e njëjtësoi dhe e cilësoi atë

¹ “Mua më ngjan se ideja e një perëndie personale është një koncept antropologjik, të cilin nuk mund ta marr seriozisht”, - thoshte Albert Ajnshtajni. “Unë gjithashtu nuk mund të imagjinoj ndonjë vullnet apo synim jashtë sferës njerëzore... Sjellja etike e njeriut duhet bazuar në mënyrë efektive te simpatia, edukimi, si dhe lidhjet dhe nevojat sociale”. Albert Ajnshtajn, “Religion and Science”, *New York Times Magazine*, November 9, 1930.

si “armiçësore”.² Madje përputhur kësaj logjike, feja dhe institucionet fetare u ndaluan me ligj duke u konsideruar si “armik i klasës”.³

3. Historia tregoi se krijesat që PPSH-ja dhe Enver Hoxha gatuan, i ngjanin metaforës së asaj qenies mitike njeriingrënëse (p.sh. figurat e Kronosit, Saturnit etj.), sikurse ishte në fakt krejt produkti i parafabrikuar i të ashtuquajturit Njeriu i Ri. Për ta krijuar këtë njeri të ri, PPSH-ja përpiqej ta suprimonte Zotin dhe fuqinë e tij të pakonkurrueshme në shpirtrat e njerëzve. Kështu, në vitin 1967, PPSH-ja ndërmoi aksionin politik të shkatërrimit të fesë dhe institucioneve fetare, e vlerësuar si një nga ngjarjet më të rënda të historisë së periudhës komuniste. Por, nga ana tjetër, krahas konceptit materialist të Ajshtajnit që e shihte Zotin si “produkt antropologjik”, historia e mendimit njerëzor njëjtte edhe konceptin idealist, që nuk e konsideronte të tillë. Duhet sjellë në vëmendje këtu mendimi i Volterit, sipas të cilit historia kishte dëshmuar se autoriteti abuziv i një lideri absolut që merrte atributet e Zotit në tokë duke iu larguar konceptit të Zotit real, shkonte vetiu drejt intolerancës, kësaj alternative të kobshme me xhelatët dhe militantët kundër fesë dhe besimit në Zot.⁴ Kjo hipotezë e Volterit a nuk u dëshmuar e gjitha në rastin e lëvizjes kundër fesë dhe të institucioneve të saj në Shqipëri në vitin 1967?

Pushteti shpirtëror i fesë

Goditja cinike ndaj klerit dhe fesë, që “përbënte dimensionin më absurd e më të dëmshëm”,⁵ shkaktoi një traumë sociale e kombëtare të

² *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1976*, neni 37 (Tiranë: 8 Nëntori, 1976), 14.

³ Luan Omari, *Shteti i së drejtës*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimi i dytë (Tiranë: Elena Gjika, 2004), 48.

⁴ “A duhet feja jonë që është hyjnore, - shkruante Volter, - të mbretërojë përmes urrejtjes, përmes tërbimit, përmes shpërnguljesh, përmes grabitjes së të mirave, burgjeve, torturave, vrasjeve dhe përmes lutjeve për falje drejtuar Zotit për këta të vrarë? Sa më shumë që feja e krishterë është hyjnore, aq më pak i takon njeriut që ta komandojë; në qoftë se Zoti e ka bërë këtë fe, Ai do ta mbështesë atë pa ndihmën tuaj. Ju e dini se intoleranca prodhon vetëm hipokritë dhe rebelë: çfarë alternative e kobshme! Së fundi, a do të donit ju të mbështeteni te xhelatët për fenë e një Zoti, që u vra prej tyre dhe që predikoi vetëm butësinë dhe durimin?”. Francois Maria Oruet-Voltaire, *Traktat mbi tolerancën* (Tiranë: ISP&Edlora, 2011), 71-72.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2008), 286.

pashembullt jo vetëm në historinë e kombit tonë, por edhe në botë. “Asgjë në jetën shoqërore të asaj kohe nuk çonte ujë në mullirin e fesë”,⁶ është shprehur njëri nga ideologët komunistë, Hulusi Hako. Ndërsa Hamit Beqja, ideolog i njohur i kohës, do të shkruante se “këto tradita e zakone, sidomos anët e tyre konservatore i “bekon” ideologjia fetare”.⁷ Ai sillte si argument se nëpërmjet tyre feja forconte ndikimin e saj ideologjik dhe e jepte atë në mënyrë të natyrshme si një ushqim të përditshëm dhe të domosdoshëm. Doemos se ritet, ceremonitë dhe festat fetare gërshetoheshin me doket e zakonet dhe ato nuk merrnin ngjyrë fetare, pasi shumë syresh ushqeheshin e buronin prej saj. Feja i shpirtëzonte. Prandaj, duke njohur pushtetin shpirtëror të fesë dhe besimin fetar, ky studiues pohonte se “të gjitha zakonet e lidhura me akte të rëndësishme të jetës, me lindjen ose vdekjen, me mbushjen e moshës së adoleshencës ose të pjekurisë, me fejesat e martesat, me hedhjen e themeleve të shtëpisë ose vjeljen e bereqetit, me qethjen e dhënve ose shtegëtimin e tyre, vishen me rroba fetare”.⁸ PPSH-ja, sipas H. Beqjes, kishte frikën se “nëpërmjet zakonit dhe traditës feja i ngjitet kështu jetës së njerëzve si ndonjë rrodhe e keqe, që nuk shqitet dot pa dhimbje. Pikërisht për këtë arsye zakoni i vjetër prapanik shndërrohet në një forcë të madhe dhe të tmerrshme konservatore. Inercia e tij, shpeshherë e padukshme, frenon zhvillimin dhe përparimin shoqëror”.⁹

Nga kjo optikë, ideologjia komuniste bënte një paraqitje të shtrembëruar qëllimisht të raportit midis fesë dhe besimit, nga njëra anë, dhe dokeve, zakoneve, riteve, antropologjisë së një populli, nga ana tjetër. Kësodore, çdo zakoni të quajtur si të vjetër, primitiv apo të tejkaluar në kohë ajo i vishte enkas mbulesë fetare me qëllim diskreditimin e saj, paraqitjen si forcë e një mendësie të vjetër, regresive, arkaike, armike e progresit dhe e emancipimit shoqëror etj. Zakoni ushtronte kështu ndikimin e vet edhe kur ishte zhdukur, pasi sipas këtij autori, është “baza materiale ekonomiko-shoqërore që e ka lindur atë, edhe kur ai ka humbur

⁶ Hulusi Hako, “Si i bëra “gjqy Zotit” dhe propagandova ateizmin në Shqipëri”, *Panorama*, 02.02.2004.

⁷ Hamit Beqja, “Në luftë për shkallmimin e së vjetrës, të krijojmë dhe afirmojmë të renë”, marrë nga *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1973), 11.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

krejtësisht kuptimin dhe është bërë absurd”.¹⁰ Në fakt, nuk është baza materiale ekonomiko-shoqërore ajo që ka krijuar zakonet a marrëdhënien e njeriut me fenë dhe Zotin, por një spektër i gjerë e ndërveprues, i shtrirë në periudha kohore të ndryshme, hapësira demografike e kushte materiale të ndryshme. PPSH-ja e identifikonte këtë qëllimisht si produkt i shoqërisë me klasa antagoniste. Masat parandaluese e gjer ndëshkuese kundër kremtimeve fetare dhe zakoneve që rrënjëzoheshin falë feve të aplikuara nëpër shekuj, u bënë pjesë e një politike të vijueshme të regjimit komunist, e cila ishte kapilare, e shtrirë gjer në familje, duke kombinuar të ashtuquajturën metodë të edukimit komunist të njerëzve që kishin “mbeturina fetare” me masat ndëshkimore dhe demaskimin e tyre publik.¹¹

Pas Kushtetutës së vitit 1946, ku në nenin 18, thuhej: “Të gjithë shtetasve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e besimit”,¹² ligjërisht kjo e drejtë në realitetin shoqëror të asaj kohe pëson një zhvendosje. Koncepti juridik kushtetues i vitit 1950, ndonëse me fjalë ishte për respektimin e fesë, në të vërtetë ishte shndërruar pak nga pak në nul, edhe pse ende nuk ishte abroguar. Në nenin 15, thuhej: “Të gjithë shtetasit janë të barabartë pa ndryshim kombësie, race ose feje. Çdo akt që sjell privilegje, në favor të shtetasve ose që kufizon të drejtat e tyre për shkak ndryshimi në kombësi, racë ose fe, është kundra Kushtetutës dhe sjell me vehte dënime të parashikuara me ligjë. Është kundra Kushtetutës dhe dënohet me ligjë çdo provokim për të mbjellur urrejtje dhe grindje në mes të kombësive, racave dhe feve.”¹³ Neni 18 i kësaj Kushtetute u garantonte gjithë shtetasve lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit. Po kështu, kisha konsiderohej e “ndarë nga shteti”, ndërsa komunitetet fetare ishin të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Në paragrafin e katërt të këtij neni theksohej edhe përcaktimi politik: “Ndalohet që Kisha dhe Feja të shpërdoren për qëllime politike. Gjithashtu ndalohen organizatat politike me bazë

¹⁰ Po aty.

¹¹ Shih Sotir Melka, “Ta çojmë çdo ditë e më përpara luftën kundër botëkuptimit fetar”, në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1973), 19-28.

¹² *Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë së Shqipërisë, 1946* (Tiranë: 5 korrik 1950).

¹³ *Po aty*, Pjesa e parë, “Parimet themelore”, Kapitulli III, “Të Drejtat dhe Detyrat e Shtetasve”, neni 15.

fetare.”¹⁴ Paragrafi i fundit i këtij neni ofronte kompromisin e shtetit: “Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare.”¹⁵

Sikurse shihet, nga pikëpamja ligjore kushtetuese regjimi respektonte lirinë e besimit dhe sekularizmin. PPSH-ja nuk dëshironte të krijonte situata të pafavorshme. Për këtë shkak ajo luajti me dy porta: edhe bënte trysni, edhe juridikisht fliste për gjoja “lirinë e besimit”. Por në veprimtaritë e përditshme të saj ushtrohej ndikim i jashtëzakonshëm politik, ideologjik e propagandistik për ta sulmuar fenë dhe klerikët e saj si faktor regresiv. Koha ende s’kishte ardhur për goditjen e madhe të vitit 1967. Andaj vijonte të bëhej një politikë e “dyzuar”, thellësisht bizantiniste. Ndryshe shkruhej e garantohej në Kushtetutë e ndryshe sillej; ndryshe deklarohesh nëpër forume e zyra partiake dhe ndryshe veprime. Nga kjo pikëpamje, ajo ngjasonte e gjitha me metodat e një pushteti të tipit okult, karakteristike për regjimet totalitare e populiste. Përherë kishte një lloj fshehtësie a elemente të veprimeve “masone”, kur qëllimet e vërteta fshiheshin pas sjelljeve me dy fytyra e dy standarde.¹⁶ Hapi i parë nga pikëpamja zyrtare institucionale i goditjes së drejtpërdrejtë të fesë ishte veprimi i Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Shkodrës, i cili në dhjetor të vitit 1966 (doemos i instruktuar) i dërgoi një propozim qeverisë për ndryshimin e dekretligjit mbi komunitetet fetare.¹⁷ Ndër të tjera në propozimet që ky organ i pushtetit lokal bënte, kërkonte abrogimin e rolit të kishës katolike “për mirëqenien landore të popullit”, çka nënkuptonte defaktorizimin e kishës, vlerësimin e saj si element pa dobi. Ai propozonte edhe mbylljen e disa kishave, të cilat gjoja nuk kishin personel klerikal dhe kishin mbetur bosh. Propozimi tjetër prekte shkollat fetare.¹⁸

¹⁴ *Po aty.*

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ William Troy, *Myth, Method and the Future* (Boston: Chimeria, spring, 1946), 132-136.

¹⁷ Shih: *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, Fondi (më tej: F) 890, Viti (më tej: V.) 1966, Dosja (më tej: D.) 469, fl. 4, 5.

¹⁸ *Po aty.*

Fjala e Enver Hoxhës më 6 shkurt 1967, sulm i hapur ndaj fesë

Në Kongresin V të PPSH-së, 1-8 nëntor 1966, pati një “rrotullim timoni” nga qëndrimi në dukje pasiv e si në hije, drejt qëndrimit të hapur ekstremist. Enver Hoxha në fjalimin e mbajtur në këtë kongres deklaroi se lufta kundër ideologjisë fetare është luftë klasash. Pasi kishin krijuar gjithë rrethanën e nevojshme me gjoja letrat dhe informimet e shumta të bazës së partisë dhe masave të gjera punonjëse, me iniciativat dhe shprehjen e vullnetit për goditjen dhe asgjësimin e institucioneve fetare si të panevojshme, madje të dëmshme për edukimin komunist të brezit të ri, duhej më në fund edhe një përligje nga ana e kastës partiake.

Kaosi juridik i raportit të shtetit me komunitetet fetare në projektligjin e janarit të vitit 1967 krijoi kushtet e shpërthimit të gjithfarë nismave me natyrë populiste, duke nxitur një irritim të përgjithshëm kundrejt institucioneve fetare dhe klerikëve të saj. Propozimi i ardhur nga Komiteti Ekzekutiv i rrethit të Shkodrës, pasi u mor në shqyrtim nga organet e larta të PPSH-së, në fillim të vitit 1967 u ndërmor iniciativa ligjore për hartimin dhe shpalljen e vendimit të ri mbi komunitetet fetare. Duke e marrë vetë përsipër rolin prijës në asgjësimin e institucioneve të kultit, demaskimin dhe anatemimin e tyre, Enver Hoxha mbajti në datën 6 shkurt 1967 përpara disa organizatave të partisë në Tiranë fjalimin e tij të njohur, i quajtur “programatik”, që jepte lejen për shpërthimin e revolucionit kulturor në Shqipëri. “Këtë luftë të madhe, - këmbëngulte ai, - nuk duhet t’ia lëmë spontanitetit apo të kënaqemi duke thënë se brezat e rinj do ta braktisin këtë opium, ose feja dhe praktikat e saja ruajnë qenien e tyre vetëm te plakat dhe pleqtë. Kjo nuk është e saktë; ato mund të humbasin virulencën e tyre, vetëm në rast se i luftojmë e demaskojmë, kurse ringjallen, propagandohen e zgjerohen në rast se i nënvleftësojmë”.¹⁹

Disa ditë më pas, më 26 shkurt 1967, ai u dërgoi forumeve partiake një letër: “Praktikat fetare t’i luftojmë me frymën patriotike dhe

¹⁹ Enver Hoxha, “Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të partisë të rretheve “Mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare”, në *Dokumente kryesore të Partisë së Punës të Shqipërisë*, vëll. V (1966-1970), Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së (Tiranë: 8 Nëntori, 1974) 142.

revolucionare të masave”.²⁰ Pasi bën një koment mbi fenë dhe rolin e saj, lideri komunist udhëzonte qartë: “Luftën tonë kundër fesë ne duhet ta drejtojmë qartë si kundër dogmave fetare, pikëpamjeve idealiste e mistike të saj, ashtu dhe kundër disiplinave fetare, që kanë hyrë deri në zakonet e përditshme të atyre që besojnë, bile dhe të atyre që nuk besojnë, por që ndonjëherë i zbatojnë pa i ditur, pa treguar kujdes, shpesh nga forca e zakonit”.²¹

Pra, lufta orientohej në mënyrë frontale në 5 rrafshë: a) doktrinës fetare; b) filozofisë idealiste; c) klerit dhe institucioneve të tij, rrjedhimisht komuniteteve fetare e të gjitha njësisve organizative, institucionale, juridikisht të pranuar; d) dokeve, zakoneve, mendësisë, traditave, që krijojnë pjesë të rëndësishme të kulturës së jetesës në vend; e) ritualeve të ndryshme, ku përfshiheshin sidomos festat, kremtimet e ndryshme komunitare e familjare si dhe nderimet e mortit, që ishin ushqyer nga feja.²² Në letrën e tij, Enver Hoxha udhëzonte pak a shumë edhe drejtimet e mënyrat e organizimit të kësaj lëvizjeje të gjerë masash; ai tregonte shinat se ku duhej ecur, çfarë do të goditej dhe çfarë do të identifikohet si pengesë e progresit të vendit “drejt socializmit”, e krijimit të ndërgjegjes proletare dhe luftës pa kompromis kundër “shfaqjeve të huaja” etj. Me pretendimin se përmes luftës së klasave do të arrihej bashkimi dhe uniteti i popullit, u mbërrit realisht drejt një absurdi juridik. Shqipëria komuniste e shndërroi logjikën historike dhe politike në një nul sofist dhe qesharak. Një mendim interesant jep Ismail Kadare për qëndrimin e pashembullt kundër fesë.

“Hoxha, - vëren ai, - e justifikonte vendimin e tij, si përgjigje ndaj “kërkesës” së rinisë shqiptare”. “Kur e vuri në jetë këtë vendim në vitin 1968, ai përfitoi nga konteksti i lëvizjeve të atij viti në disa vende europiane, koha e lëvizjeve studentore dhe e revoltave sociale, ku ndër të tjera pati dhe lëvizje kundër kishës. Hoxha u përpoq ta justifikonte si një lëvizje progresiste. Edhe sot, unë ende nuk e kuptoj arsyen e vërtetë të këtij vendimi. Apo mos ndoshta kjo ishte një çmenduri e pastër e Hoxhës, një trill i një diktatori megalomaniak? Apo mos ndofta donte të imitonte

²⁰ Enver Hoxha, “Për të realizuar vijën e partisë”, në *Vepra 35 (shkurt 1967- qershor 1967)* (Tiranë: 8 Nëntori, 1982), 102.

²¹ Po aty, 104.

²² Për ndalimin e ritualeve fetare, pra dhe ritualet e mortit si “gjama”, shih dhe: Át Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue* (Tiranë: Hylli i Dritës, 1997), 136-139.

“miqtë tanë” kinezë, në mënyrë që të fitonte simpatinë e tyre? Kush e di?”²³

Slogani kryesor që e udhëhoqi këtë lëvizje anarkike në dukje por tejet të orkestruar në të vërtetë, që ai “kundër zakoneve prapanike dhe paragjykimeve fetare”. Enver Hoxha ndër të tjera, deklaroi: “Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t’i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave.”²⁴ Kaq mjaftonte. Leja ishte dhënë. Nga zakonet prapanike dhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, si e porositur, slogani u mor menjëherë në formën e një thirrjeje kundër fesë dhe institucioneve të saj, të cilat duhej të digjeshin me zjarr. Enver Hoxha sillte si shembull indiferentizmin e organizatës bazë të portit të Durrësit për një punëtor që, ndonëse punonte mirë dhe ishte i lavdërueshëm, natën bënte ikona (në fakt arabeska) dhe ua shiste besimtarëve duke shprehur kështu besimin e tij në Zot. Një çështje e dytë e cekur prej tij ishin martesat e vajzave në moshë të mitur, në kundërshtim me ligjin, gjë e cila u lidh me ato që u quajtën mbeturina fetare. Nuk vonoi dhe më 7 shkurt organizata e rinisë e gjimnazit “Naim Frashëri” në Durrës, e gjitha e manipuluar nga militantët dhe zyrtarët e partisë-shtet me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit dhe anëtarin e Byrosë Politike Rita Marko në krye, afishuan në qytet të parat “Fletë-Rrufe”, si një imitim i Dacibao-ve kineze. “Cilido pa frikë e me germa të mëdha të shkruajë çfarë mendon ai për punën dhe për njerëzit”, kishte thënë Enver Hoxha.²⁵

Nismës së nxënësve të shkollës së mesme “Naim Frashëri” të Durrësit iu bashkëngjiten menjëherë të rinjtë e shkollës “Naum Veqilharxhi” të Shkodrës dhe “Halim Xhelo” të Vlorës, të cilët i zotoheshin Enver Hoxhës se do ta përhapnin lëvizjen e tyre në masat e moshatarëve ideologjikisht të indoktrinuar. Të rinjtë e artizanatit të Elbasanit, nga ana e tyre, në letrën drejtuar atij angazhoheshin se do t’i çrrënjosnin zakonet dhe mbeturinat fetare nga ndërgjegjja e fshatarëve. Po të njëjtën gjë bënin, madje, edhe një grup grash të moshuara që hiqnin dorë nga besëtytnitë, ritet fetare dhe feja. Qindra letra nisën të dërgoheshin në organet partiake, ato qendrore dhe ato vendore, duke

²³ Ismail Kadare, “Shqiptarët u konvertuan me dhunë në fenë islame”, *Dita*, 10.10.2013.

²⁴ “Fjala e 6 shkurtit 1967”, në Enver Hoxha, *Raportet e fjalimeve 1967-1968* (Tiranë: 8 Nëntori, 1972), 8.

²⁵ Po aty, f. 29.

krijuar një klimë ngazëllimi me zotimin për shkuljen e fesë dhe të mbeturinave fetare. Një turmë e pafund zelltarësh shtoheshin si rënia e një orteku. PPSH-ja luajti lojën e hershme të Ponc Pilatit, se lëvizja kundër fesë gjoja kishte shpërthyer nga poshtë; se ishte një nismë e rinisë; se gjoja që dëshira mbarëpopullore dhe partia duhej t'u printe masave (domethënë turmave!); se nuk ishte drejtpërdrejt PPSH-ja që e ndërmernte, e organizonte dhe e kishte projektuar me kohë këtë lëvizje anarkiste, por vetë populli...

Nxiti e rinisë shkollore, përpunimi doktrinor i saj

Lufta kundër fesë dhe institucioneve të saj mori një tjetër dimension. Në fakt, ajo dukej se që paraprakisht e mirorganizuar. Qysh më 21 janar të atij viti në një mbledhje rinie u ngritën disa çështje të mprehta, që atakonin indirekt apo edhe drejtpërdrejt fenë, sikurse qenë: heqja nga letërnjoftimi i përcaktimit të besimit fetar, shpronësimi i institucioneve fetare, bashkimi i varrezave me besime të ndryshme në një, heqja nga lajmërimet e martesave të fjalëve “zotni”, “zonjë”, “zonjushë”, heqja e festave fetare, ndërrimi i emrave fetarë me emra të rekomanduar nga gjendja civile etj. Fill pas shkollës “N. Frashëri”, ishin nxënësit e shkollës “29 Nëntori” po në qytetin e Durrësit, e më pas u nxit dhe u orkestrua për aksionin politik të goditjes gjithë pjesa e punësuar në ndërmarrjet e ndryshme të këtij qyteti. Ashtu si rrathët koncentrikë, shumë shpejt, në një kohë rekord, lëvizja u përhap në të gjitha qytetet dhe rrethet e vendit.

“Tashmë ka ardhur koha kur priftërinjtë dhe hoxhallarët duhet ta fitojnë vetë bukën e gojës dhe jo të shfrytëzojnë djersën e fshatarësisë”, shkruhej në letrën që gjimnazistët e keqpërdorur të shkollës së mesme “Naim Frashëri” u shkruanin organeve të udhëheqjes së lartë të PPSH-së. Ata kërkonin nga ana e drejtuesve të shtypshkronjës “10 Korriku” Durrës që të merreshin masa për ndreqjen e gabimeve “historike” në qëndrimin ndaj fesë, të hiqeshin simbolet fetare të kryqit dhe të gjysmëhënës, të cilat shtypshkronja i vendoste në ftesat e dasmave, lajmërimet në raste vdekjeje etj.

Më 2 shkurt 1967, të rinjtë nën “kujdesin” e mësuesve shkuan në fshatin Shën Vlash dhe kërkuan që manastiri historik, i njohur për “Gurin e Shenjtë”, të kthehej në qendër kulturore-shëndetësore, propozim që shkaktoi zemërimin e banorëve vendas dhe nxiti reagime të forta që çuan

gati në përlëshje fizike. Kjo i detyroi organet e pushtetit që të penalizonin disa nga fshatarët e “dhunshëm” ndaj të rinjve dhe për këtë organizuan gjyqe publike. Më 17 shkurt, Enver Hoxha mori pjesë në një mbledhje në rrethin e Durrësit dhe aty, pas një shfaqjeje teatrore, i inkurajoi nxënësit e shkollës “Naim Frashëri” që të vazhdonin me entuziazmin e tyre luftën kundër “mbeturinave fetare dhe zakoneve prapanike”. Më 27 shkurt 1967, Komiteti Qendror i PPSH-së do t’iu dërgonte një letër të gjitha komiteteve të partisë në rrethe duke i porositur që të luftonin çdo shfaqje dhe manifestim të besimeve fetare, rrjedhimisht goditjen e institucioneve fetare.

Lëvizja mori përmasa “ndërpopullore”, e ngjashme me tubimet e masave njerëzore dhe gardistëve të kuq gjatë Revolucionit Kulturor në Kinë. Ishte thuajse i njëjti model. Marshime me këngë, deklarime politike me megafona dhe altoparlantë, citate marksiste kundër fesë, ligjërimi, fletërrufe, inkursione në godinat e kultit, fjalime provokuese, “demaskime” të shenjtorëve e figurave të shquara të religjionit, heqje ikonash, grisje dhe djegie të tyre, dëmtime të ikonostaseve, shkatërrime të inventarit fizik që lidhej me organizimin dhe mbarëvajtjen e liturgjisë, gjer edhe shembjet e mureve dhe rrënimet nga themeli i faltoreve të ndryshme. Gjithçka u konceptua dhe u organizua si një reagim i “vetvetishëm, popullor, nga përbrenda”. Prandaj, organet e pushtetit dhe të partisë hartuan skenarin e aksionit-tip, duke e udhëhequr vetë këtë reagim mbarëpopullor. Si rregull, aksioni do të shoqërohej me akuza të rënda dhe të shfaqura haptazi në mënyrë deklarative, në sheshet publike të qyteteve, shpesh në formë inkursionesh, mitingjesh, performimesh, shoqëruar në të shumtën me një fjalor të papërshtatshëm, sharje, tallje dhe fyerje, një bullizëm i papërmbajtur. U bë modë çpersonalizimi i njerëzve të devotshëm të klerit me shpifjet, demaskimet, sulmet e pamoralshme. Lëvizja kishte formën e anarkisë sociale, por e mirorganizuar, ku gjithçka shkelej me këmbë, ku rrënoheshin tempuj, digjeshin e shkatërroheshin ikonat, shfaqeshin qëndrime poshtëruese ndaj klerit, poshtëroheshin ata, çka nxori në syprinë pjesën e vrazhdët të rinisë dhe shoqërisë, instinktët e verbra e të pahijshme për modelin human e të qytetëruar kombëtar, duke i vulgarizuar ekstremisht kodet e komunikimit.²⁶ Janë me mijëra dëshmi që hedhin dritë mbi këtë

²⁶ Në librin e tij “Fluturimi i bletës, qytetit të Lindjes - Saranda”, Josif Papagjoni risjell episode të kësaj lëvizjeje të rinisë shkollore kundër fesë dhe kishës ortodokse të

keqpërdorim të shoqërisë e rinisë nga ana e pushtetit, të kthyer në turma të verbra e destruktive, që çoi në shkatërrimin e institucioneve të kultit dhe qëndrimet e vrazhda ndaj klerikëve. Krahas dramacitetit dhe pendesës së mëvonshme, të bën përshtypje në shumë nga këto dëshmi qasja diabolike e pushtetit, duke krijuar tensione nervore ndër njerëzit e manipuluar.²⁷

Stigmatizimi dhe akuza politike ndaj fesë e forumeve të saj mori formën e gjyqeve të montuara publike duke krijuar një trysni të pashembullt ndaj njerëzve të fesë dhe duke i vendosur përpara një kompleksi të pamerituar faji.²⁸ Pikërisht kjo lloj “prokurorie mobiliare” e ndërtonte akuzën jashtë sallave dhe proceseve normale juridike, ku mund të ngrihej zyrtarisht akuza dhe ku të pandehurit të kishin të drejtën e mbrojtjes nga shpifja.²⁹ As diskutohej për avokati ligjore dhe procese ligjore brenda praktikash të njohura juridike. E drejta e mbrojtjes ishte transferuar nga gjykata në mbledhjet publike të organizatave të masave. Në ndihmë të këtij aksioni politik dhe propagandës u shfrytëzuan institucionet kulturore, të cilat ngritën brigada kulturore duke shkuar fshat më fshat e duke bërë një punë të imët e të gjerë “edukative” me

qytetit, pushtimin e kishës dhe dëbimin e besimtarëve, prishjen dhe djegien e ikonave, poshtërimin e priftit në mënyrë publike, procesionet në qytet në formë performancash etj. (Josif Papagjoni, *Fluturimi i bletës, qytetit të Lindjes - Saranda* (Tiranë: Eneas, 2023), 348-350.

²⁷ Në revistën “Albanologji”, nr. 4, 2014, të Prishtinës, botim i Institutit Albanologjik, botohen edhe disa dëshmi dramatike për periudhën në fjalë: “Aso kohe unë isha 17 vjeçe, nxënëse pranë shkollës pedagogjike “8 Nëntori” në Peshkopi”, - shprehet Shkurte Seiti për vitin 1967, kur kishte shkuar aksioniste në hekurudhën Rrogozhinë-Fier. - Aksionistët vinin nga krahina të ndryshme të vendit (vetë zonja vinte nga Burreli). Në kujtesën e saj ka mbetur i freskët momenti, kur aksionistët i vunë kazmën kishës së Lushnjës, - thotë ajo. Më pas, vazhdon ajo, pasi u thyen dhe u shkatërrua gjithçka, përballë portës së kishës, pashë të ulur në gjunjë priftin që qante. Unë nuk e mora dot guximin që të hidhja kazmën kundër asaj kishe, por kur hyra brenda pashë ikonat e saj thuajse të thyera të gjitha. Nuk kisha parë asnjëherë ikona aq të bukura”. “Etnomjekësia në besimin fetar”, *Albanologji*, 4 (2014): 179, 180.

²⁸ “Më 1965, - thuhet më tej në këtë shkrim, - mësuesi nga Batrra, pasi mblodhi nxënësit e klasës së tij, vajti dhe shkatërroi Teqenë e Batrrës, por pas kësaj ndodhie ai u çmend. Nga njerëzit thuhej si ai kaloi (u çmend), se e kreu atë akt pa dëshirën e tij, por vetëm se e urdhroi Partia. Ishte një vuajtje psikologjike e papërbalueshme nga personi duke ditur se ai besonte verbërisht te Teqeja si vend i shenjtë”. Po aty.

²⁹ Shih: Artan Fuga, *Shtigje drejt guvës së gjarprit* (Tiranë: Ora, 2004).

popullin.³⁰ Këto të ashtuquajtura brigada kulturore dhe mënyrat e performimit të tyre ishin kopje të shëmtuara pikërisht të gardistëve kinezë: recitime poezish ateiste, deklarata e parulla politike, citime të filozofëve marksistë kundër fesë, skeçe, parodizime, këngë, valle, tallje të klerikëve. Për të “administruar” dinamikën e saj, nga kupola partiake u formua një shtab i përgjithshëm i kryesuar nga Ramiz Alia si sekretar i Byrosë Politike të PPSH-së, i cili përgjigjej për edukimin dhe ideologjinë.

Interpretimet simpliste të fesë nga Enver Hoxha

Në dokumentin tepër sekret të Komitetit Qendror të datës 27.02.1967, drejtuar komiteteve të partisë të rretheve,³¹ Enver Hoxha e emërtonte fjalën e tij për asgjësimin e fesë pikërisht si luftë kundër “dogmës” dhe “disiplinave” fetare. Në qoftë se më parë nëpër fjalime publike përpara popullit apo shkrime të botuara nëpër gazeta e botime propagandistike gjithfarëshe mbahej gjithsesi një qëndrim disi i “matur”, i “drejtpeshuar”, “parimor”, tanimë dorezat hiqeshin dhe gjithçka thuhej hapur, pa cipë, duke radhitur një sërë masash ndaj fesë. “Duke marrë parasysh se kohët e fundit në shumë rrethe është intensifikuar lufta kundër fesë, paragjyqimeve e zakoneve fetare, - u drejtohej partiakëve kryesorë të rretheve ai, - dhe me qëllim që kjo luftë të bëhet sa më drejt, pa gabime dhe më me sukses, u pa e nevojshme të jepen orientimet e mëposhtme: Feja është opiumi i popujve. Këtë të vërtetë të madhe duhet të bëjmë çmos që ta kuptojë çdo njeri, edhe ata (dhe këta nuk janë pak) që janë të helmatisur e që duhet t’i ç’helmatisim. Kjo nuk është një punë e lehtë, por as edhe e pamundur.”³²

³⁰ Në një informacion nga partiakët Dashnor Mamaqi dhe Ismail Hoxha për rrethin e Shkodrës, thuhej: “Shtëpitë e vatrave të kulturës në propagandën e tyre, nëpërmjet formave të ndryshme të aktiviteteve, trajtonin problemet e ditës, duke organizuar mbledhje tematike, biseda etj. me tema si këto: “Ta bëjmë malin porsi fushën”, “Të djegim me zjarr zakonet prapanike”, “Krezmimi - zinxhir skllavërues për brezin e ri” etj. Një aktivitet të dendur zhvilluan gjatë kësaj periudhe, sidomos në fshat, teatri “Migjeni”, estrada profesioniste dhe grupet amatore”. *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (dokumente arkivore)*, përgatitur nga Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, vëll. I (1945-1968) (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Fondacioni Konrad Adenauer Stiftung, 2022), 353.

³¹ *AQSH*, F. 14/AP - Strukturë, V. 1967, D. 20, fl. 3. Shkresë nr. 133 prot., Tepër-sekret, drejtuar Komiteteve të Partisë të Rretheve, Tiranë, më 27 shkurt 1967.

³² *Po aty*.

“Dokumenti sekret” vijon në një radhë udhëzimesh, vlerësimesh dhe masash që duheshin marrë. Porositëj që lufta duhej të ishte “frontale”, e vazhdueshme, pa ia lënë spontanitetit, sepse virulenca e dukurive fetare mund të zbehej vetëm duke i luftuar e demaskuar pareshtur. I vetëdijshtëm për rrënjët e thella të besimit në ndërgjegjen e njerëzve, Enver Hoxha udhëzonte që feja të goditej më së pari si “dogmë filozofike animiste” dhe më pas edhe në të gjitha “disiplinat konkrete”, praktikat fetare, liturgjinë, zakonet, mendësinë, idealizmin dhe misticizmin.

“Klerikët, me përjashtim të atyre katolikë, aktualisht janë injorantë dhe fenë që predikojnë e mbështesin më shumë në ruajtjen e disiplinave fetare, me anën e një liturgjie arkaike, me psoma dhe duara ose lutje të mësuar përmendësh në rastin e hoxhallarëve, pa u kuptuar as brendinë, pa lëre interpretimin e tyre filozofik.”³³

Ndonëse pohimi i mësipërm kishte pjesë të së vërtetës, që vinte nga pamundësia e përgatitjes dhe e arsimimit të klerit në shkollat fetare përkatëse, ndihet gjithsesi toni sarkastik dhe shpërfillja ndaj klerit e devocionit që ai kishte në raport me besimtarët dhe punën fisnike që ata bënin. Në saje të politikës separatiste po aq sa edhe obskurantiste që PPSH-ja bënte kundër shkollimit të klerit duke pamundësuar përgatitjen e personelit të ri me dije teologjike, numri i klerikëve erdhi gjithnjë duke u pakësuar, gjë e cila e uli në mënyrë të ndjeshme nivelin e ligjërimit, kumtimet e tyre nëpër mesha, liturgjitë dhe shpjegimet për të interpretuar kanonet e shenjta. Pa pasur shkolla fetare personeli fetar u limitua në maksimumin e vet, ndërsa sa i përket botimit të librave dhe materialeve fetare, situata ishte bërë shumë më e rëndë dhe e pakthyeshme.

“Myslimanët as kanë, as mund të kenë, dhe as mund të këndojnë dot ndonjë kuran të vjetër, pse ai është në arabisht, - qesëndiste Enver Hoxha. “Praktikisht pra ata “rrojnë” me disa bejte të kuranit që i mësojnë përmendësh, që nuk i kuptojnë dhe i transmetojnë gojarisht. Ortodoksët s’janë as më të pasur dhe as më të ngritur. Ata kanë vetëm avantazhin që ungjillin e kanë në shqip. Kurse katolikët dhe kleri sidomos është më i pasur në libra, më i ngritur vetë dhe atje ku mundin, ata vazhdojnë të zhvillojnë fenë katolike si filozofi.”³⁴

³³ *Po aty.*

³⁴ *Po aty.*

Menjëherë më poshtë ai vinte te thelbi i problemit: “Pra, bazën materiale dhe propagandistike për shumëzimin e librave fetare e kemi zhdukur. Ne kemi zhdukur gjithashtu mundësinë e nxjerrjes së kuadrove. Tash është çështja t’u prishen kishat dhe xhamitë, të vetmet mjete kryesore ku klerikët grumbullojnë besimtarët për të mbajtur gjallë besimin, qoftë edhe në forma dekadente.”³⁵

Prishja e kishave, xhamive, teqeve e manastireve, natyrisht paraqiste vështirësi, sepse kjo mund të shkaktonte zemëratë dhe rebelim te besimtarët, prandaj porositej që të mos shkohej në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ta. Duke iu referuar mjaft prej godinave të kultit dhe faltoreve që ishin prishur ndër kohë, Hoxha mendonte se prishja masive e tyre nuk do të ngjallte reaksion, pasi rinia do të shërbente si instrument trysnie, demaskimi dhe frike. Nga pamundësia e financimit shumë ngrehina qenë rrënuar, disa të tjera me kohë qenë kthyer në depo, kishin mbetur pa hoxhë apo pa prift dhe praktikisht nuk funksiononin. “Në këto forma duhet të vazhdojmë ne përderisa t’i rrafshojmë nga faqja e dheut tonë”, - porosiste lideri komunist. “Institucioneve fetare ne duhet t’u heqim, atje ku kemi lënë diçka, të gjithë tokën, ndonjë ulli ose të ardhur tjetër që mund të kenë akoma kishat, xhamitë etj.”³⁶

Duke sjellë një paraqitje të vulgarizuar të ritit mysliman, si dhe faktin që Kurani dhe faljet duhej të bëheshin në gjuhën arabe, çka është e vështirë për besimtarët fshatarë shqiptarë dhe hoxhallarët mbetur pa shkollat përkatëse, Enver Hoxha bën një interpretim ideologjik të kotësisë së fesë dhe karakterit të saj reaksionar. Madje, ai provokonte ndjenjën patriotike të shqiptarëve duke e përzier qëllimisht fenë myslimane me pushtuesit turq, të cilët erdhën gjoja nën emrin e Perëndisë duke fshehur kështu synimet e tyre imperialiste.

“A mund të imagjinohet që shqiptari të vazhdojë t’u bindet ligjeve të të huajve, - bënte pyetjen retorike ai, - ligjeve të pushtuesve, qofshin këto ligje të veshura me petkun e fesë e të shariatit? Të vazhdosh t’u bindesh këtyre ligjeve e zakoneve, do të thotë të jesh shpirtërisht me të huajt, me reaksionin më të zi të huaj.”³⁷

Duke i mëshuar me qëllim kësaj ideje, ai përziente besimin fetar me pushtimin dhe eksportimin e saj nga ana e pushtuesve, rrjedhimisht

³⁵ *Po aty.*

³⁶ *Po aty.*

³⁷ *Po aty.*

duke e shndërruar në diçka të imponuar, të padobishme, armiqësore etj. Kjo logjikë nuk i adresojë vetëm fesë myslimane, por edhe asaj të krishterë, që kishte ardhur po nga pushtimet e huaja, në këtë rast nga romakët dhe bizantinët. A i qëndron së vërtetës kjo tezë, që në dukje duket mikluese e populiste? Pa dyshim, jo. Fetë kanë karakter kozmopolit, janë globale dhe nuk vijnë domosdoshmërisht përmes pushtimeve. Enver Hoxha i jepte qëllimisht kah ideologjik implementimit të besimeve të ndryshme në Shqipëri duke i lidhur posaçërisht me pushtuesit, për të ngacmuar nervin nacionalist të shqiptarëve. Publicisti Fatos Lubonja, lidhur me sa më sipër, do të theksonte në një studim të tijin në revistën “Përpyjekja”, se: “Ai që e çoi në ekstrem frymën e mitit “Feja e shqiptarit është shqiptaria” ishte bash Enver Hoxha. Në ethen e tij për pushtet absolut ky diktator u udhëhoq nga dy ideologji. Ajo nacionaliste dhe ajo komuniste. Madje dora-dorës që komunizmi si fe përbashkuese dhe frymëzuese e humbi fuqinë e vet, Hoxha i mëshonte gjithnjë e më shumë elementit kombëtar në propagandën e tij. Sipas historianit Bernd Fisher, me gjithë pikëpamjet radikale staliniste të Enver Hoxhës, thelbi i politikave të tij ishte nacionalizmi: trajtimi i tij i ashpër ndaj komuniteteve fetare duhet parë së pari në këtë drejtim”.³⁸

Enver Hoxha e zëvendësoi qëllimisht luftën ndërmjet dasive fetare me luftën kundër fesë në tërësi, duke integruar atje konceptin ideologjik marksist me vizionin ateist të botës dhe definicionin e njohur të Marksit se “feja është opium për popullin”. Shpjegimin historik të praktikave fetare organet partiake udhëzoheshin që ta gërshetonin me nxitjen e “patriotizmit të masave”, një logjikë kjo absurde dhe antihistorike, e cila mund të funksiononte vetëm në kontekstet e demagogjisë politike dhe të populizmit, sikundër edhe u veprua në të vërtetë. Fushata që e shoqëroi aksionin e prishjeve të kishave e xhamive u frymëzua dhe u nxit nga porositë që E. Hoxha jepte për t’u shpjeguar masave se “ç’vuajtje, ç’mjerime, gjakderdhje e shtypje ka pësuar populli ynë, veçanërisht nga feja, se si ajo na përçante, vinte në luftë vëllanë kundër vëllait për të na shtypur më mirë, për të na robëruar më lehtë dhe për të na pirë gjakun në emrin e fesë”.³⁹

Në fakt, ky shpjegim është më shumë një gënjeshtër dhe mashtrim propagandistik, pasi e kundërta ka qenë vektori historik sundues. Në të

³⁸ Fatos Lubonja, “Editorial: Feja dhe shqiptarët”, *Përpyjekja*, 17.10.2011, 6.

³⁹ *AQSH*, F. 14/AP – Str., V. 1967, D. 20, fl. 3.

tërën e vet prej fesë populli shqiptar nuk ka pasur vuajtje, mjerim, shtypje dhe gjakderdhje siç pretendohet! Ka pasur veçse ndihmë, solidaritet, lehtësim të vuajtjeve, çlirim nga trysnia dhe fshikujt psikikë, pamundësitë, sëmundjet dhe lëngatat. Doemos njihen disa konflikte e ngjarje që shfaqën ndonjë prirje të tillë, por ato kanë qenë të izoluara dhe asnjëherë nuk kanë marrë përmasën e një fenomeni historik kombëtar. Pa dyshim ka pasur çaste të vështira kur dasitë dhe konfliktet fetare kanë marrë forma më të shprehura, siç ka qenë për shembull kryengritja haxhiqamiliste e vitit 1914 dhe ‘velloja’ e saj fetare, kërkesat vorioepirote të një pjese të klerit ortodoks për bashkim me Greqinë, përplasjet fetare në Përmet pas Shpalljes së Pavarësisë, fërkimet fetare në Shkodër etj. Gjithsesi, asnjëherë Shqipëria nuk ka përjetuar një konflikt të hapur dhe të mirëfilltë fetar.

Më tutje, Enver Hoxha bën një provokim të dytë ndaj fesë, tashmë tejet të rëndë. Nga të tria komunitetet fetare, ai diferencon në mënyrë djallëzore myslimanizmin nga krishterimi. Këtë të fundit, krishterimin, e identifikon me karakterin më “reaksionar”, më shtypës e më idealist që ai ka, si feja ortodokse ashtu dhe ajo katolike. Sipas tij, kjo ishte e shprehur sa në zhvillimin e dogmës, në përmbajtjen e saj, në liturgjinë e ngarkuar, të rafinuar dhe pompoze, aq edhe në praktikat e në disiplinat fetare. Ky përcaktim lidhej me ndryshimin midis misionit dhe qenësisë së Muhamedit vetëm si profet, domethënë *njeri*, të cilit “Zoti” i transmetoi vetëm urdhrat e tij, të përmbledhura në Kur’an. Përkundrazi, Krishti është *Perëndia* i bërë njeri, i zbritur mbi tokë për të kumtuar Dhiatën e Re. Edhe në ritualet, faltoret dhe liturgjitë fetare, Hoxha bën diferencime që shoqërohen krahas cinizmit dhe provokimit ndaj komuniteteve fetare e besimtarëve të tyre, edhe me një interpretim irracional, alogjik, provokues e destruktiv. Sipas tij, në myslimanizëm xhamia konsiderohet si një vend i thjeshtë për mbledhje, ndërsa kristianizmi i konsideron kishat frone të Zotit, ku manjifikohet Perëndia dhe minimizohet qenia njerëzore, skllavërohet shpirti dhe shtypet ai tok me trupin nën një liturgji të tmerrshme e pompoze, nën një luks të shfrenuar të klerit dhe të katedraleve, nën një praktikë të tmerrshme e të përditshme që i qepet besimtarit, qysh kur lind e derisa vdes.

Pasi poshtëronte në mënyrë të pashembullt e të mbushur me urrejtje, përbuzje dhe një inat irracional fenë e krishterë, ritin, liturgjinë, besimin dhe vetë Perëndinë, ai e drejtonte anatemën kundër gjoja shtypjes, grabitjes dhe poshtërimit që ajo u kishte bërë besimtarëve. Sa

ishite gjallë, shpjegonte Enver Hoxha, kisha jo vetëm u merrte besimtarëve pasurinë nëpërmjet një mijë zakoneve grabitëse, praktikës frymëmbytëse dhe skllavërimit brutal, por kleri dhe feja nëpërmjet një mijë teorive animiste, përpiquej të ruante te njerëzit edhe kultin, edhe praktikatat “e shpirtit të të vdekurit” të katër deri gjashtë mijë vjet më parë, siç ishin çuarja në varre e grurit, kuleçve e zahireve të ndryshme, të cilat, natyrisht [vini re se çfarë cinizmi dhe paturpësie përdorte E. Hoxha! - E.P.] “grumbullohen në mbrëmje nga priftërinjtë dhe ua shesin në mëngjes besimtarëve, u merrnin kështu këtyre shpirtin, u rripnin lëkurën.”⁴⁰ Në fakt, i gjithë ky shpjegim ishte një diversion i hapur. “Feja kristiane, - përfundonte ai, - duhet thënë se është më e egra, më reaksionarja. Por të gjithë derrat një fytyrë kanë”.⁴¹

Dhe si për të kryer një aktpadi gjithëpërfshirëse për karakterin antikombëtar të feve, të ardhura sipas tij nga pushtuesit dhe jo si pjesë e jetës dhe historisë së popullit shqiptar, Hoxha konkludonte: “Një armë historike kundër fesë dhe klerikëve reaksionarë është edhe fakti se feja myslimane ka qenë ideologjia e pushtuesve turq, feja ortodokse ideologjia e shovinistëve grekë që pushtonin në kohët e kaluara vendin tonë dhe feja katolike me qendër Vatikanin ka qenë ideologjia e pushtuesve italianë, e imperializmit austriak dhe e fashizmit italian.”⁴²

Ishte pikërisht kjo urrejtje, ky qëndrim irracional, kjo paturpësi, që i dha motiv lëvizjes së rinisë dhe masave popullore të manipuluar, gati si një “hakmarrje” ndaj fesë, faltoreve, klerit dhe institucioneve të saj. Feja në asnjë kohë, sipas PPSH-së, nuk është vlerësuar si faktor përparimtar. Përkundrazi, ajo kishte luajtur rol reaksionar dhe, ca më keq, nuk kishte dhënë as ndihmën më të vogël për çlirimin kombëtar!

Udhëzim i rëndësishëm i Enver Hoxhës drejtuar komiteteve të partisë dhe komunistëve ishte adresimi i luftës te zakonet, traditat, mënyra e jetesës, interpretimi i fenomeneve, për të shmangur helmin e fesë, ku dhe si shfaqej ajo, në ç’formë, çfarë trajtash paskësh marrë gjatë shekujve, ç’praktika zbatonte, si i zbatonte dhe si e kamuflonte “qëllimin”. Ai tërheq vëmendjen për zakonet e ngulura në popull nga feja që kur fëmija lind, pagëzohet, bëhet synet, kur njeriu martohet në kishë në prani të priftit me formulën e betimit, kurorëzimin dhe gjer te vdekja e

⁴⁰ *Po aty.*

⁴¹ *Po aty.*

⁴² *Po aty.*

përcjellja në varr me rituale të posaçme fetare etj. Për këtë arsye, porosiste ai, duhej mbajtur parasysh fuqia e këtyre zakoneve në popull.

Enver Hoxha ishte sa populist, aq dhe dinak. Të zптоje xhamitë dhe kishat me fushatë dhe me një urdhër, ishte relativisht punë e lehtë. Ai e dinte se feja ishte rrënjosur shumë thellë te njerëzit, ishte bërë vetëdije, mënyrë jetese, zakon, doke, antropologji, histori, ndjeshmëri, mistikë. Prandaj feja duhej mposhtur e larguar përmes një “punë të vazhdueshme e të thelluar ideologjike” për ta zëvendësuar me një tjetër “fe”, me filozofinë marksiste. Vetëm kështu për besimtarin e kthyer tashmë në “njeriun e ri të edukuar nga partia” s’do të kishte më rëndësi xhamia apo kisha, prifti ose hoxha. Memoria e tij fetare do të fashitej.

“Shumë kisha dhe xhami po braktisen dhe po rrënohen”, konstatonte Hoxha dhe aty për aty urdhëronte: “Asnjë ndërtim të mos u bëhet. Disa mund të kthehen në vepra muze, në qoftë se janë të tilla, disa që do populli, të bëhen depo, të mos hezitohet të merren, e kështu me radhë, jo me dhunë, me bujë dhe pa marrë aprovimin e popullit, i cili duhet përgatitur shpirtërisht dhe politikisht.”⁴³ Më tutje, Enver Hoxha kërkonte që të bëheshin diferencimet e domosdoshme midis klerit, nga njëra anë, dhe besimtarëve, nga ana tjetër. Ai porosiste që të mos konfliktoheshin hapur me ta, sepse midis besimtarëve kishte edhe njerëz të ndershëm, të lidhur me partinë dhe patriotë të flaktë që do të ruanin në ndërgjegjen e tyre edhe për shumë kohë, mundet edhe derisa të vdisnin, besimet e tyre. Prandaj puna me ta duhej të bëhej që të bindeshin për politikën antifetare të partisë me durim të madh. Veprimet e pamatura, ekzaltuese, duhej të evitoheshin. Çdo veprimi i duhej përgatitur me kujdes terreni politik.

Defaktorizimi i fesë përmes rrënimit të tempujve dhe infrastrukturës së saj

Vitet 1967-1968 shënojnë periudhën e shkatërrimit të infrastrukturës dhe logjistikës së komuniteteve fetare, shembjet, rrënimet e godinave: kisha, xhami, teqe, manastire, tyrbe etj. Nga një bilanc i tyre rezultojnë 2 169 objekte kulti të shkatërruara ose që ndërruan destinacion dhe u kthyen në depo, gjer edhe stalla bagëtish etj. Numri i klerikëve të burgosur arriti në 217 veta, të gjithë të akuzuar për vepra penale kundër

⁴³ *Po aty.*

pushtetit dhe rendit kushtetues, armiq, agjentë apo bashkëpunëtorë të armiqve të atdheut, për kërcënime, shantazhe dhe terror ndaj popullit, sidomos për “agjitacion dhe propagandë”, neni më i parapëlqyer i akuzës, i parashikuar edhe në Kodin Penal të vitit 1977 për “propagandën fetare dhe përhapjen e liturgjisë”.⁴⁴ Shumë prej këtyre klerikëve nga të gjitha komunitetet fetare u internuan dhe iu nënshtruan persekutimeve, jo pak syresh vdiqën nëpër burgje ose u pushkatuan.

Në Shkodër, si qendra e katolicizmit shqiptar, e njohur me rezistencën e fortë ndaj komunizmit, në datën 15 shkurt 1967, as dhjetë ditë nga fjala e Enver Hoxhës, nisi mbi të sulmi frontal. Në të gjitha kishat dhe xhamitë e Shkodrës, në orën 10 paradite, ishin vendosur “Fletë-Rrufe” të përmasave të mëdha që të lexoheshin lehtësisht nga kalimtarët. Përmbajtja e tyre ishte një akuzë e rëndë ndaj institucioneve fetare në përgjithësi, ndaj klerit të të gjitha besimeve, duke i ngarkuar ata me faje e misione të paqena si bartës dhe mbrojtës të errësirës, obskurantizmit, prapambetjes, mashtrimit të masave, gënjeshtreve, madje edhe si shfrytëzues dhe grabitës të djersës së popullit. Atyre u bëhej thirrje që të braktisnin petkat fetare, të riedukoheshin dhe të punonin në profesione e punë të ndryshme për ta “nxjerrë bukën e gojës vetë e me shpatullat e tyre”. Kleri duhej të dorëzonte tempujt, të cilët do të ktheheshin në qendra të argëtimit publik e veprimtarive edukative kulturore e politike, organizimin e shfaqjeve teatrore e koncertale, lojërave sportive, muzeve apo edhe me destinacione të tjera.

E gjithë kjo histori e orkestruar drejtpërdrejt nga PPSH-ja dhe Enver Hoxha duke përfshirë një arsenal të paparë propagandistik, shtypin, librat, radion, kinematografinë dhe televizionin, mijëra shkrime, artikuj, pohime, denoncime, reportazhe, komente, biseda, sesione e konferenca (të ashtuquajtura “shkencore”), mbrëmje tematike dhe mbledhje të hapura me lektorë e ligjërata pafund, kërkonte t’i jepte një motiv masës së militantëve, posaçërisht rinisë së manipuluar, në aktin e tyre të pritshëm anarkik e terrorist. Trysnia ndaj fesë, klerit dhe institucioneve të saj, “do të njihte kulme të papara, duke marrë madje formën e një terrori ndaj klerikëve dhe besimtarëve, me qëllim që t’i largonte ata nga besimi te Zoti. Në qendër të goditjes u vunë rregullat, ritet dhe ceremonitë fetare, që përbënin thelbin e botëkuptimit fetar”.⁴⁵

⁴⁴ *Kodi Penal i RPSSH, 1977* (Tiranë: 8 Nëntori, 1977), neni 24.

⁴⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, 286.

Aksioni nisi dhe u përhap me një shpejtësi të rrufeshme në të gjitha skajet e vendit. Pikërisht më 19 shkurt 1967, njerëz të Sigurimit të Shtetit dhanë urdhër të pushonte veprimtaria e Kishës Katedrale dhe ceremonia e saj, e lajmëruar për në orën 10, të mos mbahej më. Kjo shkaktoi hutim, zemërim dhe një ndjenjë revolte te besimtarët, të cilët ishin përgatitur të dëgjonin meshën e orës 10 dhe kishin mbushur katedralen. Disa përfaqësues të pushtetit vendor në qytetin e Shkodrës i kërkuan klerit të lartë katolik monsenjor Ernest Çobës si dhe atë Agustin Ashikut që gjithë inventari fizik i françeskanëve të hiqej nga Mitropolia dhe të bartej për në kuvendin e françeskanëve te Arra e Madhe. Më pas, udhëheqja e kishës u urdhërua që të lironte ambientet e Katedrales së Madhe dhe misionarët që banonin aty të barteshin me gjithë plaçkat e tyre e të transportoheshin te Kuvendi i Arrës së Madhe. Selia e Argjipeshkvisë së Shkodrës u kthye në një vend ku po kryhej një nga aktet më të shëmtuara: bastisja e saj. Vetëm një muaj pas fjalimit famëkeq të Enver Hoxhës, më datë 4 mars 1967, më në fund u mbyll edhe Kisha e Madhe Katedrale e Shkodrës. Kishin mbetur vetëm dy kisha, ajo e Fretërve të Gjuhadolit dhe ajo e Zojës Ruzare te Arra e Madhe.⁴⁶

Përplasje njerëzish ndodhnin shpesh në kishat e rrethit të Shkodrës. Nga njëra anë masa e rinisë, në të shumtën duke kënduar, recituar, vallëzuar me orkestrina popullore, njësoj si procesionet e rinisë në Revolucionin Kulturor Kinez dhe, nga ana tjetër, besimtarë të shqetësuar dhe të trembur që shfaqeshin pranë kishave për të marrë kungimet dhe për të kryer ritualet e tyre. Ky tension i brendshëm shpirtëror krijonte herë-herë debate të forta, refuzim. Por dhuna, jo vetëm ajo verbale, qe e pashembullt. Më 18 mars, organet e pushtetit dhe të Sigurimit të Shtetit i zhveshën nga detyra e tyre si meshtarë 20 veta nga kuvendi i françeskanëve në Arrën e Madhe, sido që ata nuk ishin dakord të braktisnin detyrën e shenjtë.

Në qytetin e Lezhës ndodhi edhe ngjarja që u shndërrua në ngasje për gjithë masën e rinisë shkollore e më gjerë, e shpërdoruar dhe e shfrytëzuar nga pushteti politik: u rrëzua kambanorja e kishës së Kuvendit Françeskan. Paçka se ishte dita e Pashkëve katolike më 26 mars 1967, një masë e madhe njerëzish dhe disa përfaqësues të saj të

⁴⁶ Imzot Zef Simoni, "Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri nga 1944-1990", në *Krishtërimi ndër shqiptarë, Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 Nëntor 1999* (Shkodër: Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, 2000), 368.

vetëshpallur si “Kuvendi i tre brezave të Lezhës”, kumtuan vendimin e këtij forumi “mbarëpopullor” në 15 pika, ku as më shumë e as më pak kërkohej ndalimi i fesë dhe veprimtarive të institucioneve të saj, çka do të thoshte prishja e çdo veprimtarie dhe anulimi i funksioneve të tyre, prishja dhe shkatërrimi i simboleve, rrëzimi i kambanoreve, prishja dhe djegia e ikonave e ikonostaseve, shembja e gjithë strukturës arkitektonike dhe ajo e inventarit fizik të mjediseve kishtare si tipologji ndërtesash të caktuara kulturi, ndryshimi i gjithë arredimit specifik të faltoreve duke ua ndryshuar destinacionin e funksionet si institucione kulturi, të nesërmen e pritshme. Xhamia qendrore e qytetit të Durrësit, me pretekstin se “qe ndërtuar për qëllime të caktuara politike nga fashizmi italian dhe e inauguruar nga eksponenti i tij Jakomoni, duhet të pushojë së funksionuari për qëllime fetare dhe të kalojë në pronësi të përbashkët të popullit”.⁴⁷

Gjendja e arkave dhe e llogarive rrjedhëse të të gjitha institucioneve fetare deri në fund të muajit mars të këtij viti ishte 1 959 307 (lekë të rinj). Krahas kësaj, ato posedonin edhe sasi të konsiderueshme bagëtish, vreshtash, ullinjsh, bahçesh etj. Vetëm 8 manastire kishin 500 krerë bagëti të imëta dhe të trasha, kryegjyshata bektashiane posedonte 34 dynymë tokë që i kaloi NBSH-së “Gjergj Dimitrov” etj.⁴⁸ Një pasuri tjetër e luajtshme dhe e paluajtshme vazhdonte të ishte në duart e klerit. Ajo arrinte mbi 6 milionë (lekë të rinj), nga të cilët 2 150 000 milionë i kishin teqetë bektashiane. Komunitetit Mysliman iu shpronësua 3 163 hektarë tokë dhe 61 000 rrënjë ullinj.⁴⁹ Rreth 950 klerikë të të gjitha besimeve, nga të cilët 550 hoxhallarë dhe afro 400 priftërinj, dervishë, shehlerë etj., u detyruan ose të punonin në profesione e punë të ndryshme të rëndomta, ose të pensionoheshin nga pamundësia fizike, moshore, sëmundjet, ose të tërhiqeshin në rrethet familjare për jetesë nga pamundësia e fitimit dhe ushtrimit të një profesioni të ri etj.⁵⁰ Deklasifikimi i klerit, ndëshkimet dhe penalitetet juridike nga ana e

⁴⁷ *Komunizmi dhe revolucioni antifetar në Shqipëri*, 24/04/2012, gazeta online “DurrësLajm”. <https://durreslajm.al/komunizmi-dhe-revolucioni-antifetar-ne-shqiperi/> (shikuar më 08.12.2023)

⁴⁸ Shih Harilla Papajorgji, “Disa drejtime të lëvizjes revolucionare kundër fesë pas Kongresit V të PPSH”, në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1973), 30, 36.

⁴⁹ Shih *AQSH*, F. 890, V. 1966, D. 469, fl. 4, 5.

⁵⁰ Shih Papajorgji, “Disa drejtime”, 32.

shtetit dhe e organeve të drejtësisë sikurse penalitetet morale nga ana e organizatave shoqërore, përveç goditjes dhe skualifikimit të tyre, la edhe besimtarët në udhë pa krye. Rrethana e krijuar shkaktoi trandje psikike, situata stresi, komplekse frike dhe mosbesimi, trysni, dhunë.

Prishjet dhe shkatërrimet e faltoreve fetare prej piramidës institucionale të shtetit dhe shoqërisë shqiptare si një lëvizje e mirorkestruar dhe destruktive, solli humbje të konsiderueshme sa u përket vlerave kulturore dhe trashëgimisë që ato përfaqësonin në pikëpamje historike, arkitekturore, antropologjike, piktorike e artistike. Qindra e mijëra vende të shenjta të rrënuara, faltore, simbole, punime të larmishme si objekte dhe relikte të shenjta, me CV-të e pasura historike, libra dhe biblioteka me tituj të shumtë, të vjetër e të rinj etj., ishte një bilanc i frikshëm. Në këtë rrënim tërësor bënë përjashtim “vetëm disa objekte me vlera të veçanta, të cilat u arrit që të ruheshin”.⁵¹ Rrënimet e ndodhura s’ishin vetëm pjesë e simbolikave të religjioneve përkatëse, të konsideruara prej tyre si “trashedentale, eskatologjike, mbinatyrore, mistike, hyjnore etj.”. Ato qenë po aq edhe pjesë e trashëgimisë kulturore të popullit, dëshmi identitare të kulturës së tij, pjesë imanente e fuqisë krijuese, artistike e shpirtërore.

Synimi i PPSH-së ishte krijimi i një shoqërie tërësisht ateiste, jo vetëm të dekretuar përmes ligjit themeltar të shtetit, por edhe si vetëdije, botëkuptim, ndjeshmëri, veprim, rit social etj. Tempujt dhe faltoret po shembeshin e shkatërroheshin, u vihej kazma gjithandej ose ndryshonin trajtë. Brenda pak ditëve u rrafshua kisha e *Shenjtores së Zojës së Këshillit të Mirë* pranë kështjellës së Rozafës. *Katedralja e Madhe* fillimisht u projektua të bëhej muzeum por më pas ndryshoi destinacion dhe u kthye në pallat sporti. U bë sallë kinemaje *Kisha Françeskane* e Gjuhadorit, ndërsa një fat tjetër pati kisha e *Shenjtores së Shnandout* në Laç të Kurbinit, e cila u rrënuar dhe u bë pjesë e një territori ushtarak ku ndalohej çdokush që të shkonte e të kryente ritualet e lutjes dhe të përfaljes. Kjo faltore që e veçantë dhe sipas besimit të njerëzve, mrekullibërëse. Ishin bërë të zakonshme procesionet, ritualet dhe udhëtimet e besimtarëve nga gjithë Shqipëria, të krishterë por dhe myslimanë, traditë që kisha e *Shnandout* nuk e humbi edhe pas rrënimit që pësoi në vitin 1967. Dhe pikërisht fill pas rrëzimit të diktaturës në vitin 1990, aty filluan po njësoj, madje edhe më dukshëm, pelegrinazhet e

⁵¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, 287.

mijëra e mijëra besimtarëve të cilët kryenin lutjet dhe ritualet e tyre përfalëse për shëndet, shërim të njerëzve të sëmurë, begati e shpresë. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me pelegrinazhet në teqenë bektashiane të Kulmakut në malin e Tomorrit, jo vetëm të besimtarëve bektashinj por të të gjitha besimeve. Një akt barbar i pashembullt ndodhi me kishën e vogël të Vaut të Dejës, e cila qe selektuar edhe si monument kulture, e llojit të veçantë dhe me histori shumëshekullore, e ndërtuar në shek. XIII, një nga objektet e kultit që kishte mbërritur deri vonë si shenjë e pakundërshtueshme identitare shqiptare. Afresket e saj u bënë copë e thërrime, duke humbur kështu pjesë të pazëvendësueshme të vlerave artistike e piktorike kombëtare.

Më 29 qershor 1967 pushoi së ekzistuari nga funksionet e saj liturgjike kisha “Zemra e Krishtit” në Tiranë, ndërsa dy kishat e fundit katolike që u mbyllën qenë kisha e fshatit Sheldi dhe ajo e fshatit Delbinish. Kjo e dyta përkoi me ditën e Rrëshajave të vitit 1968; u mbyll në mënyrë të dhunshme, madje shkaktoi revoltë te besimtarët e fshatit, të cilët e mbrojtën sa mundën dhe më në fund u stepën nga kërcënimet e policisë së shtetit. Sipas raportit informativ të KQ të PPSH-së prej 23 faqesh “*Mbi Rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj*”, datë 30.08.1967, në një nga pasazhet e tij shkruhet: “Me përjashtim të kishës së madhe të Tiranës dhe kishës katolike, në të gjithë vendin janë mbyllur të gjitha kishat, xhamitë, teqetë, tyrbet, vakëfet etj.”.⁵² Vetëm për disa prej tyre u dha porosia të ruheshin për arsye muzeale, ndërsa të tjerat të konfiskoheshin e të ktheheshin në depo për kooperativat.⁵³ Në mënyrë cinike raportohej se “shteti u lehtësua gjithashtu nga subvencioni që bënte çdo vit për pagesat e rrogave e të pensioneve të një pjese të mirë të klerikëve, shifër kjo që arrinte çdo vit në 300. 000 lekë të reja”.⁵⁴ Sipas po këtij raporti informativ, aksioni për marrjen e kishave dhe të xhamive u zhvillua në të njëjtën kohë edhe kundër dogmave, riteve e besimeve fetare, që përbënte thelbin e luftës. Kjo e transferoi atë brenda familjes, andaj dhe vlerësohej “si lufta më e mprehtë, më e gjerë dhe më e thellë sesa marrja e kishave dhe xhamive. Ajo prek e trondit direkt ritet fetare si botëkuptim, festat e zakonet që janë futur e shkrirë në jetën e përditshme të njerëzve... Si pasojë e kësaj

⁵² AQSH, F. 14/AP, V. 1967, D. 191. Raport informativ “Mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj”, 30 gusht 1967.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty.

pune, një pjesë e ikonave, kandilave, librave fetarë, mbishkrimeve etj., që ishin simbole të perëndisë në shtëpitë e besimtarëve dhe që çdo ditë u faleshin, u likuiduan dhe u dorëzuan”.⁵⁵

Format populiste të kritikës dhe demaskimit të fesë e klerikëve

Të ashtuquajturat kuvende për demaskimin e fesë dhe institucioneve të saj u mbajtën në të gjitha rrethet e vendit sipas aksiomës romake *Divida et Impera*. Populli i kooperativës “Ylli i kuq” të Shënkollit në kuvendin e saj, për shembull, mori vendim ta kthente kishën në shtëpi kulture dhe ta dëbonte priftin e saj. Të bën përshtypje në këto raste jo thjesht indoktrinimi i masave në aksionin e prishjes së institucioneve fetare, por natyra represive e këtij aksioni, ku fshihej frika dhe njerëzit detyroheshin të shtreshin, pa i shfaqur mendimet dhe ndjenjat e tyre të vërteta. Ata qenë tejet të tjetërsuar. Kjo shpjegohet me krijimin e histerive kolektive dhe indoktrinimet falë një propagande shurdhuese, stepjes, pamundësimit të mendimit të lirë, shtypjes së çdo nisme për kundërshti dhe qëndrim “ndryshe”, çka fliste për mënyrat populiste se si bëheshin këto kuvende, po aq edhe për një fundamentalizëm politik të llojit të “revolucioneve” jakobine e lëvizjeve anarkike. Trysnia që kaq e madhe sa mendimi kundër ishte i papërfillshëm, inekzistent. Bie fjala, në kuvendin e Shënkollit nga 446 veta, vetëm katër dolën kundër vendimit që kisha të kthehej në vatër kulture.⁵⁶

Si për të sfiduar kishën, shteti hapi në Shkodër më 10 korrik 1968 në mjediset e saj një ekspozitë me titullin “Mbi rolin reaksionar të fesë”,

⁵⁵ *Po aty*.

⁵⁶ “Më 4 dhjetor 1966, në orën 10 p.d. - lexohet në procesverbalin e kuvendit të fshatit Shënkoll, - u mblodh e gjithë organizata e Frontit të fshatrave të bashkuara Shënkoll dhe Rrillë. Morën pjesë në mbledhje gjithsej 450 veta, prej të cilëve burra 313, gra 117, të rinj e të reja 54. Nga këta kishte dhe pleq e plaka mbi 112 veta. Mbledhjen e drejtoi kryetari i Frontit të fshatit të bashkuar. Ai tregoi qëllimin e mbledhjes dhe ia dha fjalën popullit... Mbase puna u shoshit mirë, propozimi u hodh në votë. 446 veta ngritën gishtin lart. Vetëm 4 votuan kundra. Ky ishte një akt patriotik për popullin e zonës sonë. Kthimi i kishës në shtëpi kulture dhe largimi i priftit që një fitore tjetër e rëndësishme e popullit të fshatit tonë në luftën kundra ideologjisë fetare dhe mbeturinave të tjera që rrjedhin prej saj.” Gjystina Shyti, “Kisha e Shën Kollit, shfrytëzuese e pamëshirshme e Bregmatasve”, në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1973), 56.

ku silleshin materiale të ndryshme gjoja “historike”, foto-dëshmi, shkrime, thënie etj., të cilat në përgjithësi e paraqisnin fenë si pjesën më të zezë të vetëdijes së shoqërisë dhe njerëzve, si vegël e reaksionit borgjezo-revizionist dhe Vatikanit, si faktor destruktiv dhe përçarës e unitetit të popullit. Të panumërta qenë gjoja “dëshmitë” dhe akuzat në këtë ekspozitë-muze, ku kleri dhe feja akuzoheshin si faktorë të manipulimit politik, që krijonin dasi, që shërbenin si instrumente të shtrembërimit të të vërtetave historike dhe atyre shoqërore, që mpinin nervin e kundërshtimit dhe rebelimit në popull duke bërë thirrje për nënshtrim, përlulsi etj. Ca më shumë, bashkësitë fetare konsideroheshin gjer edhe si organizata “kriminale”, që kishin bashkëpunuar me pushtuesit si dhe akuza të tjera të këtij lloji. Ekspozita të tilla u hapën në të gjitha qytetet dhe rrethet e vendit dhe propaganda u bë kapilare. Aty mohohej çdo gjë e mirë e dobishme që feja përfaqësonte. Ekspozita e Shkodrës, e pasuruar me dokumente të tjera, u shndërrua në “muzeun ateist” si një megafon i përhershëm propagande për të krijuar sa më shumë dyshime e të pavërteta ndaj klerit katolik. “Megjithëse më të kulturuarit dhe me kredite të shumta në lëvizjen kombëtare shqiptare, - nënvizon me të drejtë Ana Lalaj, - ata kanë qenë më të persektuarit në Shqipërinë e Pasluftës së Dytë Botërore”.⁵⁷

Manifestimet e masave të rinisë shkollore, pionierëve, rinisë punëtore e asaj fshatare u mandatuan si modeli i “reagimit social të masave”, të kthyer në një faktor trysnie e frike të paparë. Njerëzit trembeshin se mos i etiketonin si “mbështetës të fesë”, domethënë “armiqtë vijës së partisë”. Të hutuar dhe të trembur, ata strukeshin në shtëpitë e tyre. Madje tjetërsimi dhe frika qenë kaq të mëdha, sa edhe brenda për brenda familjes dhe njerëzve të besuar nuk bëhej më fjalë për fenë dhe çfarë kishte ndodhur me institucionet fetare. Tema ishte e rrezikshme. PPSH-ja me gjithë makinerinë e fuqishme propagandistike, duke orientuar në detaje levat e saj, organizatat e masave, gjente rast dhe i godiste hapur ato, në formën e demaskimit publik. Kjo formë e përzishme dhe e neveritshme u kalua gjer në teprim; ajo i ngjante një maskarade ku njerëzit ngriheshin dhe “dëshmonin” të këqijat e fesë. Diçka e tillë ngjau edhe me punimet e Kongresit të Gruas në Shkodër, më 11 qershor 1972. Pikërisht për ta sfiduar hapur fenë, ky kongres u

⁵⁷ Ana Lalaj, “Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj fesë dhe grupeve fetare në Shqipëri”, Studim i paraqitur në Kongresin Amerikan, *Studime historike*, nr. 3-4 (2004): 228.

zhvillua në mjediset tashmë të transformuara të Kishës Katedrale. Karshillëku ishte thellësisht cinik, i paskrupullt. Të gjitha diskutimet e bëra atje sikur donin të thoshin se tanimë Kisha Katedrale nuk ishte më ajo vatra ku njerëzit vinin e luteshin, faleshin, kryenin pendesat e tyre, ose krezmoheshin, merrnin sakramentet, ndanin ditët e lumtura të martesës dhe kurorëzimit, lindjes e pagëzimit të emrit; nuk ishte më vendi ku festonin së bashku Krishtlindjet, mësonin nga kumtimet dhe ligjërimet e meshtarëve në ditë të shënuara të kalendarit të krishterë. Tashmë ajo ishte vend kongresesh politike, ku shahej e përgojohej karakteri sakral i fesë.

Qëndrimet ambiguede dhe ato qëndrestare të klerit ndaj dhunës së ushtruar

“Mund të biem prapë në gabime, po të mendojmë se tani xhamitë dhe kishat i prishëm, priftërinjtë dhe hoxhallarët rruan mjekrat, dhe kjo punë mori fund, - porosiste militantët partiakë Enver Hoxha në një tjetër fjalim të tij të vitit 1967. Po të mendojmë kështu dhe të mendojmë pse zhdukëm mjetet, harrojmë që kjo që bëmë është vetëm alfa. Përpara është akoma më e madhja për të bërë...”⁵⁸

Por cila ishte më e madhja?! Më e madhja ishte indoktrinimi i brezit të ri me ideologjinë komuniste, ai që u quajt Njeriu i Ri, pra njeriu ateist dhe zhdukja e çdo botëkuptimi idealist. Regjimi mori përsipër ta çshenjtëronte fenë dhe gjithë strukturën e saj mentale të besimit, përfshi liturgjitë, ritualet, kalendarin e figurave profetike, testamentet dhe kanonet e shenjta, veprën e shenjtoreve; ai shpotiti hapur pelegrinazhet në vendet e shenjta, stigmatizoi ngjarje e objekte të lidhura me religjionet përkatëse, duke i paraqitur ata (fenë, klerin dhe institucionet fetare) si pjesën më të zvetënuar, më injorante, më irracionale dhe më reaksionare të shoqërisë. E gjithë veprimtaria dhe propaganda antifetare, e bërë vit pas viti dhe në gjithë indet e shoqërisë, u adresua më në fund në sulmin irracionel të turmave të keqpërdorura e të indoktrinuara nga PPSH-ja, kryesisht të rinisë shkollore, duke shkatërruar gjithë inventarin dhe infrastrukturën e klerit shqiptar. Kjo u pasua nga krijimi i hendeqeve morale e shpirtërore në popull (deri edhe ato filozofike në rrafshin e

⁵⁸ Enver Hoxha, “Si ta forcojmë partinë dhe si ta edukojmë atë”, *Vepra* 35, 312.

teologjisë, pikëpamjeve ateiste, gnostike, mistike etj.), teksa gjithçka mbushej me koncepte dhe ide materialiste e marksiste.

Frika dhe trysnia ishte aq e madhe, sa edhe tjetërsimi i klerikëve kaloi gjer në ekstremin e vet, në absurd. Një pjesë e tyre, për t'i shpëtuar etiketimit si “armik i partisë dhe i popullit” mori pjesë vetë në prishjen e faltoreve. Tjetërsimi dhe dyfytërsia, kryesisht i klerit të ulët, u shfaq si një dukuri sa tragjike, aq edhe absurde. U arrit deri aty sa ata mbronin vijën e ashpër të Partisë Komuniste duke u bërë thirrje grigjës së tyre që të merrnin pjesë në votime dhe të mbështesnin 100% kandidatët e Frontit Demokratik, që të bashkoheshin rreth partisë kundër armikut të jashtëm e të brendshëm. Kjo ngjau sidomos me disa klerikë bektashinj. “Duke i njohur këta klerikë, - këshillonte Enver Hoxha organet e partisë në bazë, - ne mendojmë se për këtë zell që kanë treguar nuk janë shtyrë nga ndonjë qëllim i keq, pse ata janë të lidhur me popullin dhe me pushtetin. Gjesti i tyre, sido që i shpejtuar, prapë i shërben interesit të përgjithshëm. Ai është një gjest patriotik dhe i guximshëm nga ana e tyre, pse pavarësisht se do të vazhdojnë të besojnë në fe, ata thyen një traditë shekullore, gjë që i nderon ata, pse në vetvete është një mendim dhe vendim përparimtar. Por, do të ishte më politike që ata të kuptonin dhe të ndihmonin, duke ndjekur me kujdes taktikën dhe strategjinë e partisë, në luftën kundër feve. Do të ketë njerëz në popull që nuk do t'i aprovojnë veprimet e këtyre klerikëve. Ne nuk duhet të qëndrojmë shirxhinj, por t'i mbrojmë në qëllimet e tyre të mira dhe shumica e popullit, e në radhë të parë të rinjtë dhe të rejtat, do t'i aprovojnë. Kjo ka rëndësi të madhe. Por, nga ana tjetër, ka rëndësi që kjo çështje të mos bëhet një problem kapital dhe të diskutohet: duheshin prishur kishat dhe xhamitë, bënë mirë këta klerikë apo nuk bënë mirë? Çdo gjë për këtë duhet të kalohet dhe të bëhet pa bujë, me durim, me konsekuencë, në rrugën që ju shpjeguam më lart.”⁵⁹

Sipas Ajet Shahut, “energjitë për paqe të popullit, shteti komunist i shfrytëzoi jo pak. Me to ai lehtësoi barrën e qeverisjes, pa ndjerë shumë nevojë për partnerë të tjerë të jetës civile”.⁶⁰ Më tej, ky autor vë në dukje se PPSH-ja dhe lidershipi i saj synonte ta injoronte rolin mobilizues të faktorit shpirtëror që përfaqësohej nga feja “sikur besimi për të nesërmen

⁵⁹ AQSH, F. 14/AP – Str., Komiteti Qendror, V. 1967, D. 20, fl. 3. Shkresë nr. 133 prot., Tepër-sekret, drejtuar Komiteteve të Partisë të Rretheve, Tiranë, më 27 shkurt 1967.

⁶⁰ Ajet Shahu, “Shteti komunist dhe kisha katolike”, në *Krishtërimi ndër shqiptarë, Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999* (Shkodër: Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, 2000), 356.

nuk buronte vetëm nga Zoti, por reflektohej si atribut i shtetit”. Prej këtu zë fill “gërryerja e rolit shpresdhënës” të dogmës fetare, për të konfirmuar “rolin frytdhënës” të dogmës politike, të veshur edhe me meritat e fitores së luftës antifashiste”.⁶¹ Duke ndjekur politikën e diferencimeve politike midis klerit, PPSH-ja miklonte atë pjesë klerikësh që nuk donin të përcaktoheshin si armiq të saj, përkundrazi që shfaqnin gjer edhe devotshmëri për t’i shërbyer politikës që ajo ndiqte. Pati klerikë që bënë thirrje madje (dhe kjo ishte më absurdja) për të braktisur besimin përmes pendesës sipas këshillave që jepte partia, duke marrë pjesë vetë në aksionet politike të saj etj. Fenomeni në vetvete ishte paradoksal. Veprime e sjellje të tilla motivoheshin me lidhjet që ata kishin me Partinë Komuniste përmes pjesëmarrjes në luftë, të familjarëve të tyre si militantë partiakë apo edhe nga arsye subjektive të ndryshme. Gjithsesi, këto qëndrime nuk përbënin një argument logjik, ngaqë sjelljet dhe deklaratimet e tyre ishin pasojat e një tjetërsimi të thellë, që kishin deri diku për ligjien e vet historike dhe, siç theksonte Roland Barthes në shpjegimin e këtij fenomeni të njohur psikologjik, mitologjia politike e kohës në kushte dhune, tjetërsimi dhe indoktrinimi, krijonte masën sociale homogjene.⁶²

Duhet pohuar me forcë se, pavarësisht disa qëndrimeve të tilla, pjesa e iluminuar dhe qëndrestare e klerit shqiptar gjatë dhe pas vitit 1967 vuajti persekutime të vrazhda. Sipas imzot Zef Simonit, Selia e Shenjtë dhe vetë Papë Pali IV qenë të shqetësuar për fatin tragjik dhe martirizimin e tij. Ai u kishte thënë kardinalëve të ardhur nga gjithë bota me rastin e kremtimit të Krishtlindjeve të vitit 1972 në Konçistor se: “Na kemi ba të pamundurën për t’u marrë vesh me shqiptarët për lirinë e besimit. Por ata qëndrojnë në të vetën. U sillemi kardinajve të vendeve të tjera, të merren me këtë çashtje tue gjetë të gjitha mënyrat e mundshme për zgjidhjen e këtij problemi fort të rëndësishëm”.⁶³ I jashtëzakonshëm e

⁶¹ Po aty.

⁶² “Masa dhe miti i perkasin njëri-tjetrit, - shkruan Roland Barthes. - Masa bëhet e vetëdijshme me ndihmën e mitit. Më saktë, miti lind bashkësitë e njerëzve, sepse ai drejtohet mu në zemër të njeriut. Miti asgjëson veçimin e njerëzve. Ai kryen punën e bashkërendimit të punëve njerëzore. Ai ndihmon të vendoset marrëveshja. Miti është fillesë organizuese. Prej tij vjen frymëzimi, të cilit njerëzimi i detyron ekzistencën dhe madhështinë. Miti plotëson dhe forcon atë besim, mbi bazën e të cilit kryhen punë të mëdha historike”. Roland Barthes, *Mythologies* (Paris: 1958), 87.

⁶³ Cituar sipas Simonit, “Persekutimi i kishës katolike”, 384.

trimëror ishte qëndrimi i atë Pjetër Meshkallës. Më 29 prill 1967, organet e Sigurimit të Shtetit e arrestuan atë në Institutin Pedagogjik “Luigj Gurakuqi”, i cili e kishte shfaqur hapur mendimin e vet për natyrën armiqësore të regjimit komunist ndaj fesë dhe forumeve të saj, madje duke e refuzuar sy për sy qëndrimin dhe politikën zyrtare të regjimit përballë Kryeministrit të vendit, Mehmet Shehu.

Ja si i drejtohej atë Pjetër Meshkalla Kryeministrit Shehu më 5 prill 1967: “Një hije e zezë ka ra mbi popull kur ka pa tue u mbyllë Kishat, tue u rrëzue kumbonarët e sidomos tue u lejue të viheshin në lojë personat dhe gjanat fetare, tue fye kështu thellë ndjenjat kaq të shenjta të besimit... Unë vijën e tanë jetës sime nuk mund e ndryshoj, por do ta vazhdoj derisa të kem frymë. Pengesa e jashtme e forcës madhore do të bajë në mue vetëm at efekt që ban guri o dheu që pengon rrjedhën e ujit: Populli më njeh dhe e din mirë si kam shkri jetën për té... Unë tham se, me këtë luftë kundra fesë neve edhe po diskreditohe mi faqe botës, së cilës i kemi dhanë premtime solemne për liritë dhe të drejtat njerëzore në Shqipni”.⁶⁴

Disa përfundime

Nxjerrja jashtë ligjit e fesë dhe e forumeve të saj, penalizimi i një pjese të vyer e të përzgjedhur të klerit që kishin frymëzime antikomuniste, sikundër shkatërrimi masiv e tërësor i institucioneve të kultit, solli disa pasoja. Ndër to:

- Goditja e lirisë së ndërgjegjes, e parë si e drejtë njerëzore, e cila ishte mirëfilli dhe përjashtimisht e natyrës morale e shpirtërore.

- Në kontekstin juridik të së “drejtës natyrore” dhe “kontratës shoqërore” si dy aspekte unike të ekzistencës, sipas H. Grotios-it goditja drejtohej edhe ndaj vetë “kuptimit të shtetit të së drejtës si një organizëm që është lidhur ngushtë me një tërësi parimesh dhe vlerash, të cilat, pavarësisht nga diskutimet për prejardhjen e tyre, kanë një sanksionim të përgjithshëm juridik, edhe në shkallë ndërkombëtare”.⁶⁵

- Goditja e pjesës më vitale të tij, infrastrukturës së domosdoshme për të realizuar qëllimet, funksionet dhe gjithë ritualin e parashikuar.

⁶⁴ Atë Pjetër Meshkalla, “Letër drejtuar kryeministrit Mehmet Shehu”, *Kumbona e së Diellës*, 03.03.1998; Simon Shkreli, “Letra e At Pjetër Meshkallës drejtuar Mehmet Shehut”, *KonicaAl*, 05.04.2017.

⁶⁵ Hugo Grotius, *Deti i lirë dhe prolegomena e mbi të drejtën e Luftës dhe të paqes* (Tiranë: ISP&DITA, 2000), 286.

- Ndalimi i kremtimeve dhe i festave fetare, datave të shënuara, shkollimit klerikal.

- Penalizimi në rastin e shkeljes së urdhrin. Ndëshkimet shembullore ishin unikale dhe pa precedentë në botën moderne. Fenomeni sillte paralele me periudhën historike të Perandorit romak Trajan dhe persekutimit që ai i bëri klerit të krishterë. Në fakt, në regjimin komunist në Shqipëri këto qenë shumë më të vrazhda e më kapilare.

- Asgjësimi i një premise të mundshme dhe gjeneruese për ringritjen e institucioneve dhe të infrastrukturës së bashkësive të kultit.

- Dyzimi i njeriut, defaktorizimi i tij në ushtrimin e lirisë së vetëdijes.

- Cenimi i njerit prej parimeve themelore të kohezionit dhe bashkekzistencës qytetare e kombëtare të shtetit (Charles Taylor),⁶⁶ pasi nëpër shekuj toleranca dhe vëllazërimi midis shqiptarëve me fe të ndryshme është shfaqur si një nga virtytet bazike të kombit. Synimi i PPSH-së për të zhdukur me tërësej besimet fetare duke i vlerësuar si premisa sociale me ngarkesë negative që sillnin gjoja përçarjen e popullit, krijimin e dasive dhe identiteteve sociale të vetëmbyllura (!?), në fakt rezultoi e kundërta. Heqja e besimit fetar i ashpërsoi edhe më shumë njerëzit, i bëri më të pandjeshëm ndaj tjetrit, preku solidaritetin human duke ofruar modelin e njeriut të “fabrikuar” nga Zoti-Parti.

- E drejta e besimit fetar, edhe pse nga pikëpamja juridike u suprimua si e tillë, nga pikëpamja historike dhe e qenësisë ajo vazhdoi të funksionojë e të shfaqet në forma tanimë të kamufluara. Kryerja e ritualeve të ndryshme fetare, herë individualisht e herë në grupe të vogla e tinëz syrit të pushtetit, nuk reshti asnjë moment. Mjaft nga kremtimet me zanafillë fetare bëheshin nëpër shtëpi dhe në grupe.

- Qëndrimi shpesh ambiguid i një pjese të klerit ndaj pushtetit komunist shkaktonte ndër njerëzit turbullim, paqartësi, luhatje, pasuar nga situata sociale të disfavorshme.

- Në formën e një konkluzioni të të gjithë këtij procesi, vetë Enver Hoxha në Kongresin VI të PPSH-së vinte në dukje se: “Një aksion me rezultate të mëdha është lufta për shpartallimin e ndikimit të fesë. Brenda

⁶⁶ Charles Taylor në dallimin midis shtetit të “keq” dhe shtetit të “mirë”, vërente se “shteti është kryesisht një institucion për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore mes njerëzve...”. Ludwig von Mises, *Veprimi Njerëzor. Një traktat mbi ekonominë* (Tiranë: 2000, ISP&DITA), 200.

një kohe shumë të shkurtër u arrit që t'u hiqeshin përfundimisht funksionet e tyre gjithë institucioneve dhe predikuesve të fesë, të cilët përhapnin e mbanin gjallë idealizmin dhe misticizmin më obskurantist dhe më anakronik. Shqipëria u bë një vend pa kisha e xhami, pa priftërinj e hoxhallarë”.⁶⁷

- Nga PPSH-ja pranohet se ajo e mbështeti Revolucionin Kulturor Kinez për të mbrojtur popullin kinez, edhe pse ky revolucion më pas u kritikua, duke u cilësuar si joproletar.⁶⁸

E gjithë kjo lëvizje, u shoqërua si një *copy paste* me forcimin e boshtit ideologjik në shkollë, futjen e lëndëve të njohurive të marksizëm-leninizmit, ngritjen e kultit të jashtëzakonshëm të figurës së Enver Hoxhës, falë një mitizimi thujse me natyrë religjioze. “Në shumë aspekte, thekson studiuesja E. Kambo, praktikat ekstremiste të huazuara nga ky revolucion u transplantuan mekanikisht në ambjentin shqiptar, duke sjellë pasoja të rënda që ndikuan fuqishëm në ecurinë e mëtejshme të vendit.”⁶⁹

- Në tekstin “Historia e Shqipërisë”, vëll. 4, botim i vitit 1984, pranohet se PPSH-ja mbështeti Revolucionin Kulturor Kinez për të mbrojtur popullin kinez, ndonëse ajo lëvizje, sipas përcaktimit të vetë Enver Hoxhës “nuk ishte as revolucion, as i madh, as kulturor dhe sidomos aspak proletar”.⁷⁰ Vite më vonë Ramiz Alia, në librin “Unë Ramiz Alia dëshmoj historinë” do të pranonte se, ndonëse si udhëheqësi e PPSH-së ata nuk pajtoheshin me konceptet e Revolucionit Kulturor Kinez, paradoksalisht “ne i huazuam këto konceptione ose u frymëzuam nga ‘masat e revolucionit kinez’”.⁷¹ Ndërsa sipas J. Rothschild-it, varianti shqiptar i “revolucionit kulturor”, ndryshe nga ai kinez, nuk doli kurrë jashtë kontrollit të partisë, nuk stimuloi momente të shpërthimeve

⁶⁷ Enver Hoxha. *Raport në Kongresin VI të PPSH* (Tiranë: 8 Nëntori, 1970), 131.

⁶⁸ Shih *Historia e Shqipërisë*, vëll. 4, Akademia e Shkencave e RPSSH-së, Instituti i Historisë (Tiranë: 8 Nëntori, 1984), 301; Enver Hoxha, *Imperializmi dhe revolucioni*. (Tiranë: 8 Nëntori, 1978), 384.

⁶⁹ Shih Enriketa Kambo, *Shkolla shqiptare në vitet 1960-1970*, Instituti i Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike (Tiranë: Kristalina-KH, 2014), 219-226.

⁷⁰ *Historia e Shqipërisë*, vëll. 4, 301; Enver Hoxha, *Imperializmi dhe revolucioni* (Tiranë: 8 Nëntori, 1978), 384.

⁷¹ Ramiz Alia, *Unë Ramiz Alia dëshmoj historinë* (Tiranë: Dituria, 1993), 66.

⁷² Shih Joseph Rothschild, *Kthim në diversitet* (Tiranë: Onufri, 1998), 200.

spontane që të shpinin në dhunë kolektive, poshtëtime publike ose përçarje ekonomike.⁷²

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Botime dokumentare:

Kodi Penal i RPSSH, 1977 (Tiranë: 8 Nëntori, 1977), neni 24.

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë së Shqipërisë, 1946, Tiranë: 5 korrik 1950.

Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1976, neni 37 (Tiranë: 8 Nëntori, 1976), 14.

Literaturë historiografike:

Ajnshtajn, Albert. "Religion and Science". *New York Times Magazine*, November 9, 1930.

Barthes, Roland. *Mythologies*. Paris: 1958.

Beqja, Hamit. "Në luftë për shkallimin e së vjetrës, të krijojmë dhe afirmojmë të renë". Në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1973.

"Etnomjekësia në besimin fetar", *Albanologji*, 4, 2014.

Fuga, Artan. *Shtigje drejt guvës së gjarprit*. Tiranë: Ora, 2004.

Grotius, Hugo. *Deti i lirë dhe prolegomena e mbi të drejtën e Luftës dhe të paqes*. Tiranë: ISP&DITA, 2000.

Hako, Hulusi. "Si i bëra "gjqy Zotit" dhe propagandova ateizmin në Shqipëri". *Panorama*, 2 shkurt 2004.

Historia e Popullit Shqiptar, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990), Grup autorësh. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2008.

Historia e Shqipërisë, vëll. 4. Akademia e Shkencave e RPSSH-së, Instituti i Historisë. Tiranë: 8 Nëntori, 1984.

Hoxha, Enver. *Dokumente kryesore të Partisë së Punës të Shqipërisë*, vëll. V (1966-1970). Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH-së. Tiranë: 8 Nëntori, 1974.

Hoxha, Enver. *Raport në Kongresin VI të PPSH*. Tiranë: 8 Nëntori, 1970.

Hoxha, Enver. *Raporte e fjalime 1967-1968*. Tiranë: 8 Nëntori, 1972.

Hoxha, Enver. *Vepra 35 (shkurt 1967-qershor 1967)*. Tiranë: 8 Nëntori, 1982.

- Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (dokumente arkivore)*. përgatitur nga Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, vëll. I (1945-1968). Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Fondacioni Konrad Adenauer Stiftung, 2022.
- Kadare, Ismail. “Shqiptarët u konvertuan me dhunë në fenë islame”. *Dita*, 10 tetor 2013.
- Lalaj, Ana. “Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj fesë dhe grupeve fetare në Shqipëri”, Studim i paraqitur në Kongresin Amerikan. Në *Studime historike*, nr. 3-4, 2004.
- Lubonja, Fatos. “Editorial: Feja dhe shqiptarët”. në *Përprjekja*, 17 tetor 2011, 6.
- Melka, Sotir. “Ta çojmë çdo ditë e më përpara luftën kundër botëkuptimit fetar”. Në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1973.
- Meshkalla, Atë Pjetër. “Letër drejtuar kryeministrit Mehmet Shehu”. Në *Kumbona e së Diellës*, 3 mars 1998.
- Mises, Ludwig von. *Veprimi Njerëzor. Një traktat mbi ekonominë*. Tiranë: ISP&DITA, 2000.
- Omari, Luan. *Shteti i së drejtës*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimi i dytë. Tiranë: Elena Gjika, 2004.
- Oruet-Voltaire, Francois Maria. *Traktat mbi tolerancën*. (Tiranë: ISP&Edlora, 2011.
- Papagjoni, Josif. *Fluturimi i bletës, qytetit të Lindjes – Saranda*. Tiranë: Eneas, 2023.
- Papajorgji, Harilla. “Disa drejtime të lëvizjes revolucionare kundër fesë pas Kongresit V të PPSH”. Në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1973.
- Pllumi, Át Zef. *Rrno vetëm për me tregue* (Tiranë: Hylli i Dritës, 1997), 136-139.
- Simoni, Imzot Zef. “Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri nga 1944-1990”. Në *Krishtërimi ndër shqiptarë, Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 Nëntor 1999*. Shkodër: Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, 2000.
- Shahu, Ajet. “Shteti komunist dhe kisha katolike”. Në *Krishtërimi ndër shqiptarë, Simpozium Ndërkombëtar Tiranë, 16-19 nëntor 1999*. Shkodër: Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, 2000.
- Shyti, Gjystina. “Kisha e Shën Kollit, shfrytëzuese e pamëshirshme e Bregmatasve”. Në *Materiale mbi lëvizjen revolucionare kundër fesë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1973.
- Troy, William. *Myth, Method and the Future*. Boston: Chimeria, spring, 1946.

Site:

Komunizmi dhe revolucioni antifetar në Shqipëri, 24/04/2012, gazeta on-line “DurrësLajm”.

<https://durrësLajm.al/komunizmi-dhe-revolucioni-antifetar-ne-shqiperi/>
(shikuar më 08.12.2023)

ERJON PAPAGJONI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
epapagjoni@gmail.com

S u m m a r y

1967 YEAR – HISTORY OF THE ORGANIZED ATTACK ON THE RELIGION
AND ITS INSTITUTIONS

The totalitarian system in Albania was completely dogmatic. From the optics of the philosophy of law, communism is considered a kind of messianic religion that has no God but has a Messiah. Messianism as a savior mission or according to Marx “Prometheism”, in fact, it is proclaimed in the slogan: “By liberating itself, the proletariat liberates all mankind”.

Thus the Marxist doctrine is transformed into a new Gospel, which is proclaimed by the New Savior. He is not selected, or sent by God. On the contrary, mostly he is self-elected by annihilating rivals, as the history of the political career of Enver Hoxha. A totalitarian system like the communist regime in Albania borrowed from religion the absolutism and incongruity with dogma, in our case the Marxist doctrine, which excluded from itself any other alternative thought by proclaiming to be “self-sufficient”.

This in itself led fatally to dogmatism, where nothing can be opposed, but accepted, just like in religion, where everything is believed, not doubted or even discussed. Obedience to bigotry turned into an absolute principle of recruitment, and turned the communist militant into a religious fundamentalist.